



QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

MANUAL TRAJNIMI

“INSTRUMENTET KUSHTETUESE - LIGJORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E LIRIVE TË SHTETASVE DHE ROLI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE PËR FORCIMIN E TYRE¹”

(Përgatitën manualin: Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof. Dr. Arta Mandro, Av. Erind Mërkuri, Av. Aurela Bozo)

Mbështetur nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A-së në Tiranë.

Tiranë, 2010

¹ Ky manual është hartuar në kuadrin e projektit “Forcimi i kapacitetit të Shoqërisë Civile për përdorimin e instrumenteve ligjorë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive kushtetuese”. Përgatitja dhe printimi i këtij manuali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë manual janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Përmbajtja e lëndës:

I. Prof. Dr. Aurela Anastasi, Av. Erind Mërkuri,

Roli i Organizatave jofitimprurëse për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, përmes gjykimit Kushtetues. Mbrojtja e interesave të organizatës përmes këtij gjykimi.....fq.3

II. Prof.Dr. Arta Mandro-Balili,

Avokati i Popullit si instrument efektiv dhe mbështetës në rolin e shoqërisë civile në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ndaj ç nimeve të administratës publike.....fq.40

III. Av. Erind Mërkuri, Av.Aurela Bozo

Roli aktiv i Organizatave përmes ndërhyrjes së tyre si palë të treta në proceset gjyqësore në gjykatat kombëtare dhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....fq.52

Prof. Dr. Aurela Anastasi
Av. Erind Mërkuri

ROLI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE, PËRMES GJYKIMIT KUSHTETUES. MBROJTJA E INTERESAVE TË ORGANIZATËS PËRMES KËTIJ GJYKIMI.

Hyrje. Është e rëndësishme të vëmë në dukje se organizatat dhe shoqatat janë subjekte që zënë një vend të posaçëm në nivel kushtetues, ku rregullohen aspekte themelore në lidhje me statusin dhe veprimtarinë e tyre. Kjo ndodh për shkak të rolit që ato kanë në zhvillimin demokratik të vendit.

Pa mënjanuar rëndësinë që kanë dispozitat e Kushtetutës që i pozicionojnë organizatat si subjekte të të drejtave dhe lirive themelore me cilësinë e personave juridikë², një vlerë të dukshme marrin rregullimet e hollësishme për organizimin, regjistrimin dhe funksionimin e tyre. Gjithashtu, mjaft interes paraqesin mjetet dhe instrumentet që Kushtetuta u njeh organizatave dhe shoqatave, për mbrojtjen e interesave të tyre.

Kushtetuta e ndalon shprehimisht, krijimin e organizatave që ndjekin qëllime antikushtetuese. Në nenin 9/2 ajo sanksionon: *“Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrëjtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si dhe ato me karakter të fshehtë, janë të ndaluara sipas ligjit”*.

Për sa më sipër gjykojmë se, Kushtetuta e RSh-së, duke pasur në vëmendje rolin veprimtar të organizatave për mbarëvajtjen e demokracisë në vend dhe për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, ka përcaktuar shprehimisht, rastet kur mund të ndalohet veprimtaria e organizatave. Ajo i është referuar ligjit për të përcaktuar mënyrën se si do të ndalohet kjo veprimtari, ndërkohë që ligji do të mbajë parasysh shkaqet e parashikuara nga Kushtetuta. Këtë sanksionim kushtetues mund ta lidhim edhe me nenin 46/3 të saj, i cili vendos se, *“Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit”*. Pra, qëllimet që përbëjnë shkak për antikushtetutshmëri dhe për ndalimin e veprimtarisë së organizatave, janë përcaktuar shprehimisht nga vetë Kushtetuta (neni 9), sipas rasteve që vijojnë:

- kur programi dhe veprimtaria e organizatave mbështeten në metoda totalitariste;
- kur organizatat nxisin e përkrahin urrëjtjen racore, fetare, krahinore ose etnike;
- kur organizatat përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore;
- kur organizatat kanë karakter të fshehtë.

² Neni 16/2 i Kushtetutës sanksionon: *“Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”*.

Sidoqoftë, përveç sa më sipër, mund të themi se organizatat ose shoqatat ndjekin qëllime antikushtetuese në çdo rast që çënohen ose shkelen të drejtat dhe liritë themelore të individit, apo nenet e Kushtetutës.

Në lidhje me shkaqet për antikushtetutshmëri, Kushtetuta i referohet ligjit për të përcaktuar më hollësisht mënyrën për ndalimin e krijimit të organizatave të tilla dhe për mbylljen e veprimtarisë së tyre. Në këtë kuadër, ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (OJF-të) ka përcaktuar detyra të posaçme për këto organizata. Në nenin 7 të tij ai sanksionon parimin e pavarësisë së OJF-ve dhe të mos-ndërhyrjes së shtetit në këtë veprimtari, duke theksuar se, "*...Organet shtetërore nuk ndërhyjnë në veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Ndalimi ose kufizimi i veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse bëhet vetëm në rastet dhe mënyrën e përcaktuar në ligj*".

Në të vërtetë, ky ligj nuk ka parashikuar asnjë rast për ndalimin ose kufizimin e veprimtarisë së OJF-ve, ndërsa duhet të përcaktonte shkaqe ligjore. Ai mbetet sërish në rrethana referuese duke mos qartësuar se cilëve nga ligjet u referohet konkretisht dhe, cilat do të ishin këto ligje të tjera, që mund të përcaktonin rastet për antiligjshmëri të OJF-ve. Kjo nuk bëhet shumë e qartë as nga Komentari përkatës mbi ligjet për organizatat jofitimprurëse³.

Në fakt, një përcaktim i tillë do të ishte mjaft i rëndësishëm për të mos lejuar abuzime dhe për të mos lënë shkas për ekuivok. Sidoqoftë, është e qartë se mund të legjitimohen qëllime dhe programe organizatash, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me ligjet ekzistuese. Vetë kushtetuta e lejon organizimin për çfarëdo qëllimi të ligjshëm (neni 46 i Kushtetutës), gjë që përjashton organizimin për qëllime të paligjshme. Qëllimi, programi dhe veprimtaria e organizatave nuk mund t'i kundërvihen ligjit apo të ndjekin qëllime antiligjore. Kështu, p.sh., një shoqatë e krijuar për të mbrojtur të drejtën e shtetasve për jetë private, nuk mund të kërkojë mbrojtjen e interesave të këtyre subjekteve, duke ndërhyrë me çdo mjet, për ndalimin e të gjitha rasteve të përgjimit të mjeteve të komunikimit, apo të kontrollit të tij vetjak. Ajo mund të ketë për qëllim vetëm ndalimin e praktikave të paligjshme që e çënojnë në mënyrë të paligjshme të drejtën e shtetasit për një jetë private të qetë.

Për më tepër, ligji "Për organizatat jofitimprurëse", përcakton qartë se *organizatat jofitimprurëse e bazojnë veprimtarinë e tyre në parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj*⁴. Kjo kornizë ligjore kushtëzon mjaft veprimtarinë e organizatave, të cilat mund të krijohen vetëm për qëllime të ligjshme. Moszbatimi i saj sjell pasoja të rënda ligjore për vetë organizatën⁵.

³ Shih: Komentari "Ligjet për organizatat jofitimprurëse" Instituti i Studimeve Publike dhe ligjore, Tiranë, 2003, fq. 34-35

⁴ Për më gjerë, shih: Komentari "Ligjet për organizatat jofitimprurëse" Instituti i Studimeve Publike dhe ligjore, Tiranë, 2003, fq. 29-31

⁵ Po aty.

1. Instrumentet juridiko-kushtetuese për mbrojtjen e interesave të organizatave e të shoqatave

Kushtetuta ka njohur disa garanci procedurale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat shërbejnë edhe për mbrojtjen e interesave dhe qëllimeve të organizatave e shoqatave. Këto garanci janë parashikuar në Kushtetutë, jo vetëm në dimensionin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar. Përveç Avokatit të Popullit dhe sistemit tri-shkallësh të gjykatave të zakonshme, është Gjykata Kushtetuese ajo që bën gjykimin përfundimtar të kërkesave të individëve, kur është fjala për cënimin e të drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor (neni 131/f, 134/1/ë). Organizatat mund ta vënë në lëvizje këtë Gjykatë me kërkesë, për çështje që lidhen me interesat e tyre⁶. Në këtë kuadër, garancitë që ofrohen nga gjykata në përgjithësi dhe nga Gjykata Kushtetuese në veçanti, janë shumë të rëndësishme në përmbushjen e objektit të veprimtarisë së organizatave apo shoqatave.

Organizatat janë një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, jo vetëm për çështjet individuale të organizatës, por edhe për një kontroll abstrakt të normës juridike, për çështje që lidhen me interesat e tyre. Pyetja që shtrohet është: çfarë do të kuptojmë me interesat e tyre?

Në rastin kur interesi i tyre nuk konceptohet si një interes fare i ngushtë i lidhur vetëm me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të organizatës, ato mund të shndërrohen në avokate të vërteta të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tyre. Kështu, organizatat mund të përfaqësojnë në Gjykatën Kushtetuese, interesat e qytetarëve dhe të komunitetit. Praktika e Gjykatës Kushtetuese shqiptare e ka lejuar këtë, përmes legjitimitit të organizatave kur ato e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, jo thjesht për interesat e tyre të ngushta, por edhe për interesa publike, madje edhe për interesa të të tretëve, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut dhe të vetë Kushtetutës.

Qëndrim të ngjashëm ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në rastet kur shoqata apo organizata të tjera shqiptare kanë vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të goditur si antikushtetues artikuj të veçantë të ligjeve të ndryshme. Edhe pse shpesh, ligjet që janë bërë objekt shqyrtimi kanë pasur të bëjnë me fushën dhe objektin e veprimtarisë së

⁶ Në nenin 134 të Kushtetutës sanksionohet:

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:
 - a) Presidentit të Republikës;
 - b) Kryeministrit;
 - c) jo më pak se një së pestës së deputetëve;
 - ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
 - d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
 - dh) Avokatit të Popullit;
 - e) organeve të qeverisjes vendore;
 - ë) organeve të bashkësive fetare;
 - f) partive politike dhe organizatave të tjera;
 - g) individëve.
2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët dh, e, ë, f dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

shoqatave dhe jo drejtpërdrejt me interesat e ngushta të veprimtarisë së tyre, Gjykata Kushtetuese i ka legjitimuar ato si subjekte kërkuese në gjykim, për një kontroll abstrakt mbi ligjet. Ky fakt, mund të shndërrohet më shumë, në një mjet të fuqishëm në duart e organizatave për realizimin e veprimtarisë së tyre në mbrojtje të Kushtetutës dhe të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut. Megjithatë, krahasuar me numrin e madh të organizatave dhe të shoqatave që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare, duhet pranuar se ky mjet kushtetues është përdorur rrallë prej tyre.

Në procesin gjyqësor të zakonshëm është e vështirë që një organizatë të ndërhyjë pa prokurë. Kjo mund të ndodhë vetëm në rastin kur një subjekt palë në proces, i jep organizatës të drejtën që ta përfaqësojë atë. Në fakt, gjithmonë e më tepër po shtrohet nevoja e parashikimeve ligjore që do ta legjitimonin një organizatë për ndërhyrje si palë e tretë në gjykim, ose për vënien në lëvizje të gjykimit, pa pasur nevojë për prokurë të posaçme nga pala. Vetëm në këtë mënyrë, ajo mund të shndërrohet në një avokate të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive dhe të synojë mbrojtjen e të drejtave që kanë rëndësi jo vetëm për personin palë, por edhe për publikun në tërësi. Edhe pse u tentua të parashikohej kjo në projektligjin “Për barazinë Gjinore në Shoqëri”, një parashikim ligjor për të zëvendësuar palën, apo viktimën, me qëllim që kjo e fundit të mos frikësohet nga ndjekja e procedurave, kjo nuk u arrit. Madje, nuk është arritur ky mjet as në ligjin e ri “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Parashikimi, së paku në raste të veçanta, i organizatave ose shoqatave që mund të ndërhyjnë si palë e tretë në gjykim, ndihmon në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të viktimave të trafikimit, të viktimave të dhunës në familje, apo të viktimave të diskriminimit për shkaqe të ndryshme. Kështu, duhet të shihet mundësia që të krijohet praktika gjyqësore, që në bazë të nenit 191, të Kodit të Procedurës Civile, një organizatë e shoqatë të zinte vendin si ndërhyrës dytësor në rastin kur zgjidhja e drejtë e =ështëjes midis palëve ndër gjyqëse, shihet e lidhur ngushtë me objektin e veprimtarisë së saj, me misionin dhe qëllimin që i ka vënë vetes kjo organizatë.

Një rëndësi të veçantë marrin edhe **garancitë ndërkombëtare**, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Garancitë ndërkombëtare mund të përfshijnë jo vetëm Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjë që buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta, por edhe Komitetet e ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është pjesë. Një sërë aktesh ndërkombëtare kanë krijuar **Komitete me kompetenca për të shqyrtuar ankesa të paraqitura nga qytetarë ose grupe të qytetarëve nga shtetet anëtare**. Këto janë mjete dhe instrumente shumë të rëndësishme që mund të përdoren nga organizatat për të arritur qëllimet e veprimtarisë së tyre. Sidoqoftë, në të dyja rastet mbetet disi e paqartë pozita procedurale e organizatave apo shoqatave për të ndërhyrë në këto procese. Ndoshta është e vështirë që ato të ndërhyjnë në çdo rast që kanë interes, pasi nuk e gëzojnë statusin e palës së tretë, por mund të shfrytëzojnë vullnetin e palëve për t’i lejuar ato që t’i përfaqësojnë në këto instanca ndërkombëtare. Gjithashtu, ato mund të argumentojnë përpara këtyre instancave interesin ligjor që çështja paraqet për objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së tyre, të pasqyruar në Statutin e

organizatës. Sidoqoftë, deri më sot nuk kemi ndërhyrje pranë mjeteve të tilla nga ndonjë organizatë shqiptare.

2. Mbrojtja e interesave të organizatave jofitimprurëse, përmes gjykimit kushtetues

Duke përcaktuar subjektet që mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, Kushtetuta parashikon “*partitë politike dhe organizata të tjera*”, si subjekte që mund “*të bëjnë kërkesë, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre*”⁷. Megjithatë, Kushtetuta nuk ka bërë ndonjë sqarim mbi faktin se çfarë do të kuptojmë me termin “*organizata të tjera*” dhe “*interesat e tyre*”. Ajo vetë ka arritur të veçojë si kategori të dalluar qartë, vetëm shoqatat, të cilat duhet të kuptohen si një lloj organizate dhe aspak, si një kategori e ndryshme prej tyre. Megjithatë, legjislacioni shqiptar na ndihmon të rendisim të gjitha ata persona juridikë që përbëjnë një organizatë, siç mund të jenë organizatat jofitimprurëse (shoqatat, qendrat, fondacionet), sindikatat, si dhe organizime me karakter ekonomik të njohura nga ligji. Duhet theksuar fakti se, “organizatat e tjera” janë konceptuar nga hartuesit e Kushtetutës si një subjekt i posaçëm, i dallueshëm, nga individi, partitë politike, bashkësitë fetare, apo personat e tjerë juridike. Sidoqoftë, ka qenë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, ajo që ka bërë të mundur përcaktimin e kritereve dhe kushteve që mundësojnë një organizatë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për një çështje, në bazë të nenit 134, pika 1/f e Kushtetutës.

Në mënyrë të veçantë duhet bërë krahasimi midis organizatave të tjera dhe individëve, përfshirë personat fizikë ose juridikë, të cilët mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1/g. Në këtë pikëpamje, individët, përfshirë personat fizikë ose juridikë që kanë të drejta të barabarta me ta, gjithashtu, mund të bëjnë kërkesë në gjykatën Kushtetuese. Por, kjo mundësi e tij është kufizuar vetëm në rastin kur ai pretendon shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe pasi ka shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike. Pra, individi, qoftë edhe si person juridik, nuk mund të kërkojë një kontroll abstrakt të normës, nëse pretendon se kjo e fundit vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Për më tepër, deri më sot, kontrollin kushtetues për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese e ka kufizuar në trajtimin e aspekteve procedurale të një procesi administrativ ose gjyqësor, duke mos e konsideruar si pjesë të juridiksionit kushtetues procesin e rregullt ligjor, substancial. Pra, në këtë rast, nuk kemi shanse për një kontroll të kushtetutshmërisë së normës që ka zbatuar Gjykata apo institucioni shtetëror, por vetëm për zbatimin në përputhje me Kushtetutën të normave procedurale.

Ky dallim përbën edhe një nga arsyet që dëshmon rritjen e kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga organizata të ndryshme, jofitimprurëse. Nëse vërejmë me kujdes jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, do të shikojmë se organizatat po kthehen në subjekte mjaft aktive për mbrojtjen e interesave të grupeve që ato përfaqësojnë, duke u bërë avokate të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese për qytetarët.

⁷ Kushtetuta e RSh, neni 134, pika 1/f dhe pika 2.

Përballë kësaj situatë, shpeshherë, grupet e interesit synojnë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, nëse nuk kanë arritur t'i imponojnë zgjidhjet e veta organeve shtetërore. Megjithatë, duhet të theksojmë faktin se, kjo mundësi e ofruar nga Kushtetuta nuk është e pakufizuar. Sikurse e sipërpërmendëm, paragrafi i fundit i nenit 134/2 e bashkëngjit këtë mundësi me faktin nëse organizatat janë të afta të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Sa më sipër, si dhe tendenca gjithmonë e në rritje nga organizatat jofitimprurëse, për t'iu drejtuar këtij institucioni dhe ndikimi që ka vendimmarrja kushtetuese në politikën e përgjithshme shtetërore, ka bërë që çështja e legjitimitimit (*locus standi*) e këtyre organizatave, të jetë nga më të debatueshmet. Në çdo rast që, Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesën nga një subjekt i tillë, ka analizuar këtë çështje me shumë kujdes dhe ka krijuar një jurisprudencë të pasur.

3. Përvojat e gjykimit kushtetues të kërkuar nga organizatat, në periudhën 1992-1998.

Fillimisht, e quajmë me vend të bëjmë një analizë të shkurtër me karakter historik, në 6 vitet e para të ekzistencës së Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që të shohim evolucionin e çështjes që po trajtojmë. Në vitin 1992, në kuadrin e plotësimit të legjislacionit kushtetues pas rënies së komunizmit dhe vendosjes së një rendi demokratik, Kuvendi Popullor i kohës miratoi ligjin Nr. 7561, datë 29.04.1992, "*Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese*", i cili ishte një shtojcë e ligjit kushtetues "*Për dispozitat Kryesore Kushtetuese*". Ky ligj, për herë të parë në historinë e Shtetit shqiptar, krijoi një Gjykatë Kushtetuese.

Midis të tjerave, ligji (neni 25) parashikonte subjektet që mund të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me këtë përmbajtje:

"Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose edhe me nismën e saj.

Për fillimin e procedurës kanë të drejtë të bëjnë kërkesë Presidenti i Republikës, një grup parlamentar, një e pesta e deputetëve, Këshilli i Ministrave, gjykatat, organet lokale të pushtetit, si dhe çdo person, lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij të parashikuara nga Kushtetuta".

Siç mund të vërehet në këtë rast, ligji nuk i referohet drejtpërdrejt organizatave, por *personit*. Megjithatë, gjatë viteve 1992-1998, Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje gjithsej 21 herë nga organizata të ndryshme, kryesisht, të organizuara në formën e shoqatave. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të paraqitura, u bazua në interpretimin ligjor që Gjykata Kushtetuese e kohës, i bëri termit "person". Në bazë të Kodit Civil⁸ të kohës, personat fizikë dhe juridikë ishin subjekte të së drejtës civile. Madje, në të shumtën e rasteve, çështja e legjitimitimit të tyre, as nuk shtrohej për diskutim⁹. Në vendimin e saj Nr. 2, datë 26.1.1995 Gjykata Kushtetuese trajtoi për herë të parë

⁸ Ligji Nr. 6340, datë 26.06.1981

⁹ Gjykata Kushtetuese është venë për herë të parë në lëvizje nga një organizatë në vitin 1993 kur ajo u shpreh me Vendimin Nr. 13, datë 22.11.1993. Në këtë vendim çështja e legjitimitimit nuk u shtrua për diskutim. E njëjta situatë paraqitet edhe në dy vendimet e tjera vijuese Nr.4, datë 8.4.1994 dhe Nr. 7, datë 14.4.1994 të kësaj Gjykate, ku në arsyetimin e saj ajo nuk shprehet në lidhje me legjitimin e subjekteve që iniciuan procesin kushtetues.

legjitimin e “organizatave” duke u bazuar pikërisht tek termi “person”. Në këtë rast Gjykata shprehet se ...*Përsa i përket pretendimit tjetër se urdhërimi i organeve të pushtetit lokal shkel të drejtat kushtetuese të këtyre organeve, Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk legjitimohet ta ngrejë. Ajo si person juridik, në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, “ka të drejtë të bëjë kërkesë vetëm për të drejtat e saj kushtetuese...”*. Kështu, duket qartë natyra individuale e kërkesave të organizatave, drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, pyetja tjetër që lind është: cilat ishin të drejtat kushtetuese të këtyre organizatave, që mund të kërkoheshin përpara Gjykatës Kushtetuese?

Përgjigjen për këtë pyetje mund ta gjejmë duke analizuar me kujdes natyrën e çështjeve që ka shqyrtuar Gjykata Kushtetuese, kur është vënë në lëvizje nga organizatat. Në përgjithësi, rezulton se të drejtat kushtetuese përfshinin të drejtat e individëve, grupimin e të cilëve kjo organizatë merrte përsipër që ta mbronte e përfaqësonte. Nga praktika kushtetuese nuk rezulton si kusht i domosdoshëm, anëtarësia në organizatë e këtyre individëve.

Gjithashtu, pati disa raste kur Gjykata Kushtetuese përdori kërkesën e organizatave, për t’u vënë në lëvizje me iniciativën e vetë. Kjo ndodhte kur kjo Gjykatë nuk e gjente me vend të legjitimonte organizatën si kërkuuese, por gjente me vend të shqyrtonte në thelb çështjen e shtruar prej saj. Kështu në vitin 1997, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i është drejtuar disa herë, Gjykatës Kushtetuese ku ka kërkuar shpalljen si të papajtueshme me kushtetutën të disa dispozitave ligjore. Në një nga vendimet e saj, *Gjykata Kushtetuese, me vendim paraparak, është shprehur se, Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk legjitimohet të investojë këtë Gjykatë për mospajtueshmërinë e një ligji me kushtetutën, për arsye se ky Komitet nuk përmendet ndër subjektet që kanë të drejtën t’i drejtohen kësaj Gjykate (neni 25, paragrafi i dytë i Ligjit nr. 7891, datë 29.04.1992).*

*Gjykata, duke marrë parasysh rëndësinë e problemit të ngritur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe sidomos, karakterin e veçantë që merrte ky problem në kushtet e krijuara në vendin tonë, e pa të nevojshme ta marrë atë në shqyrtim me nismën e saj...*¹⁰

I njëjti arsyetim shihet edhe në raste të tjera të ngjashme¹¹. Siç mund të konstatohet, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk e ka konsideruar Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një “person”, subjekt që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në arsyetimin e vendimit Gjykata përqendrohet në faktin se kjo organizatë nuk parashikohej nga neni 25 i ligjit kushtetues. Mendojmë se në këtë çështje, arsyetimi ishte i pamjaftueshëm për të kuptuar se, për cilën arsye Gjykata nuk e legjitimoi Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një person, por zgjodhi të vihet në lëvizje me nismën e vet, për të trajtuar çështjet e ngritura në kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Në vitin 1998 Gjykata Kushtetuese nëpërmjet një vendimi, përcaktoi se, në rast se një person juridik shuhet gjatë kohës që çështja është në shqyrtim përpara kësaj gjykate atëherë, kërkesa duhet rrëzohet për shkak se organizata *me shpërndarjen e saj e ka*

¹⁰ Shih Vendimin Nr. 14. Datë 29.05.1997 të Gjykatës Kushtetuese

¹¹ Shih Vendimin Nr. 13, datë 25.9.1997 të Gjykatës Kushtetuese

*humbur cilësinë e personit juridik për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 25 të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.*¹² Ne mendojmë se, në një rast të tillë do të ishte më korrekte nga pikëpamja tekniko-juridike që, Gjykata të vendoste pushimin e gjykimit dhe jo rrëzimin e kërkesës. Si rregull, me shpërndarjen e personit juridik që e ka vënë në lëvizje gjykatën, kërkesa, por edhe procesi i nisur para Gjykatës Kushtetuese, vetiu kthehen në *nul* dhe Gjykata në këtë rast, nuk mund që t’u japë përgjigje pretendimeve të ngritura nga subjekti përkatës.

Në përfundim, konkludojmë se qysh në këtë periudhë, u krijua praktika e organizatave jofitimprurëse për të përdorur mjetin kushtetues të vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese me anë të kërkesës, me qëllim mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të target grupeve që ato përfaqësonin. Ato shtruan për herë të parë në jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese trajtimin e disa koncepteve të rëndësishme juridiko-kushtetuese si, legjitimitimin e organizatave për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë. Kjo periudhë shërbeu për të nxjerrë konkluzionet e duhura, me qëllim përpunimin e këtij instrumenti kushtetues për organizatat edhe në Kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë.

4. Inicimi i Gjykimit Kushtetues nga organizatat e tjera sipas Kushtetutës së vitit 1998

Hartuesit e Kushtetutës aktuale, u kujdesën që të përcaktonin më mirë rrethin e subjekteve që mund të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Madje, vërejmë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton një rreth më të gjerë subjektesh në raport me disa Kushtetuta të tjera. Kështu, p.sh., nëse i referohemi Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, apo asaj të Republikës së Kosovës rezulton se, jo vetëm që rrethi i subjekteve lëvizëse të Gjykatave Kushtetuese në këto të fundit është më i ngushtë, por edhe nuk parashikohet shprehimisht vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese nga organizata të tjera.

Sidoqoftë, duhet të theksojmë faktin se në Shqipëri, parashikimi i tyre në Kushtetutë si subjekte lëvizëse për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, nuk është pa kufij. Në zbatim të nenit 134/2 të Kushtetutës, ky subjekt, ka detyrimin të provojë interesin e tij, pra, një të drejtë konkrete kushtetuese që pretendon se i është cenuar.

Nga ana e tij, Ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, është treguar i kursyer në lidhje me këtë çështje. Përveçse transponon në mënyrë identike dispozitën kushtetuese, ai nuk shkon më tej për të ofruar kritere te detajuara në lidhje me legjitimitimin e organizatave. Megjithatë, duke analizuar në tërësi dispozitat kushtetuese dhe ligjore, së bashku me jurisprudencën kushtetuese, mund të nxjerrim kriteret e nevojshme, të cilat duhet të plotësojë një subjekt i tillë për të iniciuar në mënyrë të suksesshme një proces kushtetues. Po rendisim këto kritere, si më poshtë vijon:

a) Kërkesa duhet të paraqitet nga një “organizatë”.

¹² Shih Vendimin Nr. 20, datë 10.06.1998

Në lidhje me këtë pikë është e nevojshme që të specifikojmë se çdo të kuptojmë me termin *organizatë*. Nëse i referohemi punëve përgatitore të Komisionit parlamentar për hartimin e projektkushtetutës, vërejmë se kjo çështje nuk është trajtuar, nga ana e tyre. Komisioni në këtë pikë pranoi pa asnjë kundërshtim propozimin e stafit teknik, duke mos u thelluar më tej.¹³ Megjithatë, referuar në jurisprudencën përkatëse kushtetuese,¹⁴ vërejmë se termi *organizatë* është përmendur në Kushtetutë në disa kuptime dhe në një sërë dispozitash.¹⁵ Është e rëndësishme që “organizata” të ketë personalitet juridik. Në këtë drejtim, rëndësi të posaçme merr neni 46 i Kushtetutës, i cili shpall lirinë për t’u organizuar, si dhe përcakton gjykatën si institucionin që duhet të regjistrojë këto organizata. Detyrimi për t’u regjistruar në Gjykatë dhe jo në ndonjë organ tjetër të administratës publike, tregon kujdesin e kushtetutë bërësit që krijimi dhe regjistrimi i organizatave të bëhet në mënyrë të pavarur nga vullneti i ekzekutivit, duke vendosur Gjykatën si organin më të përshtatshëm e të pavarur, që gjykon mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta i ka referuar ligjit rregullimin e të gjithë procedurës së regjistrimit të organizatave. Legjislacioni që rregullon këtë fushë është Kodi Civil dhe ligji “Për Organizatat jofitimprurëse”. Sipas këtyre akteve, organizatat si subjekte të së drejtës fitojnë personalitetin juridik nga dita e regjistrimit të tyre në Gjykatë. Pra, në momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës që administrohet nga Gjykata, këto subjekte kanë fituar njëkohësisht zotësinë juridike dhe zotësinë juridike për të vepruar. Për rrjedhojë, ato janë të afta që të ndër marrin të gjitha veprimet e njohura nga ligji. I parë në një këndvështrim të ngushtë formal, që nga ky moment, teorikisht, mund që një organizatë të vërë në lëvizje edhe Gjykatën Kushtetuese. Jurisprudenca Kushtetuese në fakt, kur trajton legjitimin *ratione personae* të këtyre subjekteve i referohet pikërisht vendimit të Gjykatës me anë të së cilit është bërë regjistrimi i tyre. Pavarësisht se janë bashkime vullnetare njerëzish, sipas ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”¹⁶, qëllimi i tyre është realizimi i një interesi publik. Është kjo arsye themelore që këto subjekte kanë parimisht të drejtën për të iniciuar një proces kushtetues. Në këtë drejtim, sipas praktikës kushtetuese, nuk është e nevojshme që anëtarësia e tyre të përfshijë të gjithë personat që pretendohet se janë prekur nga një akt normativ i caktuar.

b) Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë bërë në përputhje me rregullat statutore.

Sipas Kodit Civil dhe ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, personat juridike veprojnë nëpërmjet organeve të tyre drejtuese. Pra, në këto organe formohet vullneti i organizatës dhe po nëpërmjet tyre, ky vullnet shfaqet në botën e jashtme. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që organi i organizatës që paraqet kërkesën përpara Gjykatës Kushtetuese, të jetë i parashikuar nga statuti si organ përfaqësues, ose i autorizuar prej tyre. Për gjykatën ka rëndësi thelbësore që kërkesa të jete paraqitur nga organi kompetent, përndryshe

¹³ Shih Debati Kushtetues, Botim i OSBE, Tiranë 2006, fq.1-30,.

¹⁴ Shih Vendimet Nr. 16, datë 25.07.2008, Nr. 17, datë 25.07.2008, Nr. 31, datë 02.10.2009, Nr.4, datë 12.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹⁵ Neni 9/2, nenin 20/2, 46 dhe 50 të Kushtetutës.

¹⁶ Ligj Nr. 8788, 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

subjekti nuk legjitimohet. Këtë moment të rëndësishëm procedural e shohim të pasqyruar në dy vendime të Gjykatës Kushtetuese. Konkretisht, në vendimin Nr.40, datë 6.5.1999, Gjykata është shprehur se “...Në çështjen në shqyrtim nuk ka ndonjë vendim të organeve drejtuese të Shoqatës, Mbledhjes së Përgjithshme ose Këshillit Drejtues për të ngritur padi në Gjykatën Kushtetuese, me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 48 të Ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, siç kërkon neni 47 i Kodit Civil dhe as kërkesë të përbashkët të Kryetarit e Sekretarit të Përgjithshëm siç lejon neni 11/4 i Statutit të Shoqatës. Ka vetëm një kërkesë të nënshkruar nga Kryetari i Shoqatës dhe një prokurë me të cilën ka caktuar avokat të nënshkruar po prej tij.

...vetëm kryetari i shoqatës duke mos qenë përfaqësuesi i saj, sipas Kodit Civil e Statutit të Shoqatës, nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës....

Ndërsa në vendimin Nr. 25, datë 29.07.2008, Gjykata u shpreh se ...Kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve, e paraqitur nga kryetarja e saj, në kuptim të kompetencës që parashikohet në nenin 10 të Statutit, përmban si argument parësor, që Gjykata e konsideron të përfshirë në sferën e qëllimit të kësaj Shoqate, pretendimin për cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve e, në veçanti, të parimit të pavarësisë së gjyqësorit, që kanë të bëjnë me rolin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare si institucioni që zgjedh shumicën absolute të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë...

Pra, siç rezulton nga këto dy vendime nuk ka rëndësi se cili është organi i organizatës, në emër të të cilit paraqitet kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. E rëndësishme është që ky organ ta ketë këtë kompetencë të parashikuar në mënyrë të shprehur, në Statutin e organizatës, ose në aktet e organeve drejtuese të saj.

c) Organizata duhet të pretendojë shkeljen e një interesi vetjak.

Kjo pikë është një nga çështjet më të debatueshme në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, kohët e fundit është rihapur debati edhe për disa raste, të cilat mendohej se përbënin jurisprudencë të konsoliduar.¹⁷ Ky debat shtrohet për shkak të natyrës së kontrollit që duhet të ushtroje Gjykata Kushtetuese në këtë rast. Sipas jurisprudencës rezulton ...se procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, për arsye të një interesi publik qoftë dhe pa pasur një interes konkret subjektiv, vetëm autoritete të larta shtetërore, (subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të Kushtetutës). Pra, kushtetutë bërësi ka legjitimuar për të vënë në lëvizje Gjykatën në lidhje me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e parë të listuar në pikën 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por për një ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Mbi këtë bazë, të gjithë subjektet e tjerë, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat

¹⁷ Shih Vendimin Nr. 14, viti 2011, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin subjekti kërkues, Komitetit Shqiptar i Helsinkit, u legjitimua pjesërisht nga shumica e trupit gjykues. Ndërkohë, sipas mendimit paralel të gjyqtarës A.Xhoxhaj subjekti nuk duhet të ishte legjitimuar, ndërsa sipas mendimit në pakicë të gjyqtarit S. Sadushi, subjekti duhet të ishte legjitimuar plotësisht.

“dh”, “e”, “ë”, “f”, dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të **kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike...**¹⁸

Pra, kontrolli që ushtron Gjykata në këtë rast është një kontroll konkret që do të thotë se subjektit i është cenuar një e drejtë konkrete kushtetuese, e drejtë e cila përfshihet brenda objektit të veprimtarisë së organizatës dhe për rrjedhojë përbën edhe interesin e vetë në këtë çështje. Në vazhdim të kësaj analize rezulton se për të përcaktuar interesin konkret subjektiv të organizatës, rëndësi themelore merr objekti i veprimtarisë i parashikuar në Statutin e Shoqërisë. Siç rezulton nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, moment i cili ndan legjitimitimin e një subjekti përpara Gjykatës është pikërisht mënyra se si është formuluar objekti i veprimtarisë së Shoqërisë në Statut.

Gjithashtu, sipas jurisprudencës kushtetuese¹⁹ rezulton se, nisur nga specifika e kontrollit konkret që realizon Gjykata në këto raste, këto subjekte nuk legjitimohen që të godasin në rrugën e kontrollit kushtetues aktet normative vetëm për shkak të veseve formale që këto akte normative mund të kenë. Kjo mund të ndodhë nëse fillimisht, kërkuesit justifikojnë interesin e tyre duke provuar dhe argumentuar përpara Gjykatës cenimin e një të drejtë apo të një lirie kushtetuese, pra shkelje materiale. Vetëm nëse kalohet ky moment, atëherë Gjykata mund të shqyrtojë edhe pretendimet për vese procedurale të akteve normative të goditura nga kërkuesit. Më konkretisht, Gjykata është shprehur se, *...Përsa i përket legjitimitit të subjekteve, të cilëve u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Pra interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit... dhe më tej, në po të njëjtin vendim shprehet se, ...Në analizë përfundimtare, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ndodhemi përpara cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike. Si pasojë, përderisa Gjykata nuk konstaton shkelje të këtij parimi kushtetues, nuk mund të vijojë më tej me analizën e kontrollit abstrakt të Vendimit të Këshillit të Ministrave në drejtim të respektimit të kritereve të nenit 11/3 dhe 17 të Kushtetutës. Edhe në lidhje me pretendimin për cenim të nenit 118 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky pretendim do të merrej në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një **interes real** të cenuar nga norma e goditur. Nga analiza e mësipërme, rezultoi se e drejta e lirisë së veprimtarisë ekonomike nuk cenohet nga akti, objekt shqyrtimi, dhe për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për të iniciuar një proces kontrolli kushtetutshmërie, në lidhje me nenet 131/c dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë... ”.*

Në një rast tjetër, Gjykata, pasi konkludoi se kishte shkelje të parimit të lirisë ekonomike, vazhdoi me tej me arsyetimin e saj dhe iu përgjigj pretendimeve për antikushtetutshmërinë e aktit edhe për vese procedurale. Kështu ajo shprehet se *...Pretendimi se është shkelur neni 118/1,2 i Kushtetutës, pasi vendimi i kundërshtuar është marrë në tejkallim të kompetencave të deleguara nga neni 10, pika 5, e Ligjit nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” vlerësohet nga Gjykata si i drejtë, pasi vendimi objekt shqyrtimi, në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 nuk përmban dispozita*

¹⁸ Shih Vendimin Nr.17, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹ Shih Vendimet Nr.17, datë 25.07.2008 dhe Nr.24, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese

mbi cilësinë e lëndëve djegëse. Këto dispozita lejojnë përdorimin e një produkti dhe përcaktojnë kushtet e tregimit tij. Rrjedhimisht, këto pika të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave tejkalojnë delegimin legjislativ të bërë nga pika 5 e nenit 10 të Ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”. Sidoqoftë, nga jurisprudenca kushtetuese, për shkak të objektit të veprimtarisë por edhe natyrës së çështjeve, këtë problem nuk rezulton ta kenë organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të gjyqtarëve dhe pavarësisë së gjyqësorit. Kështu, në një vendim tjetër Gjykata është shprehur se, “...Pavarësisht se në formë, neni 81, pika 2, shkronja “a” i Kushtetutës, është normë me natyrë procedurale, në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Kjo dispozitë kushtetuese është edhe në funksion të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe pretendimi për cenimin e kësaj prerogative procedurale, i ngritur pikërisht nga një subjekt, i cili në veprimtarinë ligjore ka një mision të tillë, e bën të pranishëm ekzistencën e interesit për çështjen në shqyrtim. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve legjitimohet racione materiae të kërkojë kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën”²⁰.

Shpeshherë, në jurisprudencën Kushtetuese është vënë re edhe legjitimimi i pjesëshëm i subjekteve kërkuese. Kjo ndodh për faktin se, pavarësisht objektit të kërkesës të paraqitur nga organizata, ajo duhet të provojë dhe të argumentojë interesin e saj. Në rast se ajo e provon këtë interes vetëm për një pjesë të dispozitave dhe jo për pjesën tjetër, atëherë Gjykata do të shprehet vetëm në lidhje me dispozitat normative që mund të prekin interesat që mbron organizata dhe jo për dispozitat e tjera, pavarësisht problemeve kushtetuese që ato mund të kenë. Pra, kalimi në seancën gjyqësore përmes vendimit të kolegjit seleksionues, nuk e ezauron çështjen e legjitimitit. Edhe përgjatë seancës mund të vihet në pikëpyetje legjitimimi i subjektit për pjesë të caktuara të kërtimeve të tij. Për ta konkretizuar këtë rast mund të marrim si shembull Vendimin Nr. 35/2007, ku Gjykata konkludoi se “...Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuesit për antikushtetutshmërinë e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nuk mbart në vetvete interesin për t’u konsideruar në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si subjekt iniciues i gjykimit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike lidhur me çështje që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre. Kërkuesi legjitimohet vetëm për atë pjesë të ligjit që ka të bëjë me cenimin e interesave të pronarit të ligjshëm privat.

Pretendimi i përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave lidhur me moslegjitimitin e kërkuesit për pjesën e dispozitave të ligjit që kanë të bëjnë me pronën publike, është i drejtë.

Bazuar në përfundimin që ka të bëjë me pozitën që ka kërkuesi, sipas nenit 134, shkronja “g” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se duhet të nxjerrë në evidencë si objekt të kontrollit kushtetues, kryesisht nenet 15/1 e 2, 16/1, 17, 18, 19, 21, 25, 27, 28, 29, 30, 31 e 34 të ligjit të ankimuar...”²¹.

5. Konkluzione

²⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 25, datë 29.07.2008

²¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 35, datë 10.10.2007

Duke konkluduar sa më sipër konstatojmë me kënaqësi se organizatat e tjera shpesh kanë luajtur një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve. Kjo, duke parë edhe kufizimin e individit për të kapur gjykatën Kushtetuese vetëm për pretendimet që kanë të bëjnë me një proces të rregullt ligjor.

Vështruar Jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese, konstatojmë se të drejtat Kushtetuese që janë marrë në mbrojtje nga organizatat e shoqatat, përmes vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kanë qenë veçanërisht: e drejta e pronës dhe iniciativa e lirë ekonomike si dhe të drejta të tjera me karakter ekonomik social e kulturor. Përveç tyre, një rëndësi të veçantë ka pasur mbrojtja e garancive procedurale në procesin penal, e drejta e ankimit, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta për informim, e drejta për një jetë private të fshehtë, e drejta për barazi, e drejta për kompensim, zhdëmtim dhe rehabilitim, etj. Në mënyrë veçantë, gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga organizatat për kontrollin abstrakt të pajtueshmërisë së normës me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese ka sjellë një kontribut të rëndësishëm gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave. Kështu, ajo ka avancuar qëndrimin e saj në lidhje me parimet e rëndësishme kushtetuese, si: parimi i Autonomisë Universitare, parimi i iniciativës dhe i konkurrencës së lirë ekonomike, parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, parimi i autonomisë vendore, parimi i sigurisë juridike, parimi i standardit të fituar, etj.

Konkluzione të rëndësishme evidentojmë edhe nga pikëpamja e zhvillimit të së drejtës procedurale kushtetuese. Kështu, jurisprudenca kushtetuese ka konsoliduar interpretimin kushtetues të inicimit të proceseve kushtetuese nga organizatat. Një proces i tillë mund të iniciohet kur plotësohen disa kushte:

Organizata duhet të jetë e regjistruar, pra të ketë fituar personalitet juridik.

Kërkesa duhet të paraqitet nga organi i organizatës, të cilit statuti i ka dhënë një kompetencë të tillë.

Kërkuesi duhet të justifikojë interesin e tij. Pra, organizata duhet të ketë objektin e veprimtarisë së saj, të lidhur ngushtë me fushën e rregulluar nga akti normativ që pretendohet të jetë antikushtetues. Në këtë moment, merr rëndësi mënyra e formulimit të objektit të veprimtarisë së saj, në statutin e organizatës.

Duke qenë se kontrolli kushtetues lidhet më një interes konkret, atëherë në këtë rast, si rregull, organizatat nuk legjitimohen që të godasin për antikushtetutshmëri aktet normative për shkak të veseve të tyre formale. Këtë ato, mund ta realizojnë vetëm nëse justifikojnë shkeljen e një të drejte kushtetuese nga ana materiale.

Nëse respektohen me kujdes këto kritere, mundësia e organizatave për të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, do të jetë me e suksesshme.

ANEKS

Raste nga Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Vendimi Nr.40, date 6.5.1999

Kerkues Shoqata e juristeve te shqiperise "Dura Lex Sed Lex"

Objekti: Shpallja antikushtetues e nenit 48 të Ligjit nr.8436, datë 18.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Legjitimimi Në çështjen në shqyrtim nuk ka ndonjë vendim të organeve drejtuese të Shoqatës, Mbledhjes së Përgjithshme ose Këshillit Drejtues për të ngritur padi në Gjykatën Kushtetuese, me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 48 të Ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, siç kërkon neni 47 i Kodit Civil dhe as kërkesë të përbashkët të Kryetarit e Sekretarit të Përgjithshëm siç lejon neni 11/4 i Statutit të Shoqatës. Ka vetëm një kërkesë të nënshkruar nga Kryetari i Shoqatës dhe një prokurë me të cilën ka caktuar avokat të nënshkruar po prej tij.

Duke qëndruar çështja si më sipër, vetëm kryetari i shoqatës duke mos qenë përfaqësuesi i saj, sipas Kodit Civil e Statutit të Shoqatës, nuk legjitimohet të vejë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës.

Perfundimi: Rrëzimin e kërkesës për mungesë legjitimimi.

Vendimi Nr.12, date 21.03.2000

Kerkues Shoqata "Barazi perpara Ligjit"

Objekti: Shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", pasi vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me vetë ligjin

Legjitimimi: Nuk u diskutua

Perfundimi: Pranuar pjeserisht, Të shfuqizojë si të papajtueshme me Kushtetutën, frazën që përmban neni 10 paragrafi i I-rë i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me përmbajtjen: "... ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve".

Vendimi Nr. 47, date 28.07.2000

Kerkues Shoqata e Kryetareve te Bashkive

Objekti Shfuqizimi i pikave 2.2/4, 2.2/5 dhe 2.3/6 të V.K.M., nr.217, datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar".

Legjitimimi: Nuk u diskutua

Perfundimi: Rrezimi i kerkeses

Ndikimi: Mund te ushtrohet kontroll nga organet qendrore tek organet vendore vetem per fondet qe u kane kaluar nga buxheti i shtetit

Vendim Nr.43, date18.05.2001

Kerkues: Shoqata Kombetare e te Shpronesuarve "Pronesi me Drejtesi"

Objekti: Shfuqizimin si antikushtetues i nenit 4 të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha"", ndryshimin e paragrafeve të dytë e të tretë të nenit 1 të të njëjtit ligj dhe shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha".

Legjitimimi: Nuk u diskutua

Perfundimi Rrezimi i kerkeses

Ndikimi: Shteti duhet te mbuloje diferencen e qirase qe nuk paguajne dot familjet e pastreha.

Vendim Nr.185, date 26.11.2001

Kerkues: Shoqata Kombetare e te Shpronesuarve "Pronesi me Drejtesi"
Objekti: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.12, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.
Legjitimimi: Nuk u diskutua
Perfundimi: Rrezimi i kerkeses
Ndikimi: Aktet administrative individuale nuk mundet qe te behen objekt kontrolli nga Gjykata Kushtetuese.

Vendimi Nr.206, date 24.12.2001

Kerkues: Shoqata Kombetare e te Shpronesuarve "Pronesi me Drejtesi"
Objekti: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i pikave 5, 6 e 7 të udhëzimit nr.1, datë 23.2.1999 "Për kriteret e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.666, datë 26.10.1998 "Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve e të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore", nxjerrë prej Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit, si dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.
Legjitimimi: Nuk u diskutua
Perfundimi: Rrezimi i kerkeses
Ndikimi: Nuk mundet qe te kerkohet antikushtetueshmeria e nje akti normativ pasi kane kaluar 3 vjet, nga hyrja e tyre ne fuqi. Aktet e papublikuara nuk kanë fuqi juridike, nuk sjellin pasoja juridike dhe per rrjedhoje nuk mund te goditen ne Gjykatën Kushtetuese.

Vendimi Nr. 208, date 24.12.2001

Kerkues Shoqata Kombetare e Radiotelevizoneve
Objekti Papajtueshmëria me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 4 të ligjit nr.8655, datë 31.7.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".
Legjitimimi Nuk u diskutua
Perfundimi Pushimi i gjykimit te ceshtjes
Ndikimi: Kur kërkesës i ndryshon njëkohësisht si objekti, edhe subjektet e interesuara, ajo merr cilësinë e një kërkesë të re, ndërsa kërkesa e parë mbetet pa objekt. Në kushtet të tilla, Gjykata Kushtetuese është e detyruar që të vendosë pushimin e çështjes për mungesë të objektit të kërkesës.

Vendimi Nr.135, date 17.06.2002

Kerkues Shoqata e Industrialisteve dhe e Investitoreve te Shqiperise
Objekti Shfuqizimi si antikushtetues i neneve 30 e 36 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", si dhe neneve 21 dhe 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
Legjitimimi Nuk u diskutua
Perfundimi Rrezimi i Kerkeses
Ndikimi: Fakti nëse detyrimi tatimor mbi fitimin do të parapaguhet ose jo, ka të bëjë me mënyrën e aplikuar në ligj të mbledhjes së tatimeve, dhe jo me antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite.

Vendimi Nr.4, date 17.02.2003

Kerkues Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise
Objekti Shfuqizimin si antikushtetues i vendimit nr 441, datë 26.9.2002 të Këshillit të Ministrave "Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve"
Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Pushimi i gjykimit te ceshtjes

Vendimi Nr.15, date 17.04.2003

Kerkues Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Objekti Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 410/2 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002.

Legjitimimi Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë e njohur për veprimtarinë e saj në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i cili sipas statutit, ka si objekt dhe qëllim vëzhgimin e gjendjes lidhur me këto të drejta. Duke patur një qëllim të tillë, ai ka statusin e një kërkuesi të legjitimuar, sipas nenit 134 të Kushtetutës.

Perfundimi Pranimi i Kerkeses. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në nenin 410 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, të fjalëve “nga i pandehuri”.

Ndikimi: Shkelet parimi kushtetues per mbrojtje ne procesin penal, Kuvendi nuk ka pasur parasysh jurisprudencen kushtetuese, e cila eshte e detyrueshme.

Shënim:Me Vendimin Nr.30/2010 Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar jurisprudencen e saj duke u larguar nga qendrimi qe ka mbajtur ne kete vendim.

Vendim Nr. 25, date 30.07.2003

Kerkues Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Objekti Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 437 pikat 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 483 paragrafi i dytë dhe pjesërisht paragrafi i tretë të Kodit të Procedurës Civile.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Rrezimi i kerkeses

Ndikimi: Në funksion të sigurimit të një mbrojtje sa më efektive, vetë specifika e trajtimit të çështjes në këtë fazë në Gjykatën e Lartë imponon disa veçanti. Problemet që shtrohen aty kanë karakter të mirëfilltë ligjor, prandaj diskutimi i tyre kërkon përgatitje dhe nivel të lartë profesional. Në emër të të pandehurit apo palëve në gjykim, një gjë të tillë mund ta realizojë me profesionalizëm avokati i tyre. Ai i ka të gjitha mundësitë dhe aftësitë për të mbrojtur realisht dhe me efikasitet përpara Gjykatës së Lartë interesat e subjektit që përfaqëson. Pikërisht për këto arsye, ka raste që edhe nga këndvështrimi formal, vende të ndryshme ofrojnë zgjidhje të ngjashme me atë të vendit tonë e procesi në Gjykatën e Lartë quhet edhe si “Procesi i Avokatit”

Vendimi Nr.34, date 08.12.2003

Kerkues Qendra për zhvillimin dhe demokratizimin e institucioneve

Grupi shqiptar i të drejtave të njeriut

Lidhja e gazetarëve shqiptarë

Shoqata e gazetarëve profesionistë

Sindikata e gazetarëve shqiptarë

Objekti Deklarimi si antikushtetues i urdhrit nr.226, datë 20.8.2002 të Kryeministrit “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Pushimi i Ceshtjes

Ndikimi:Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur nuk ka më objektin e saj, sepse urdhri që kontestohet nuk ekziston, pasi ai është revokuar nga vetë organi që e ka nxjerrë.

Vendimi Nr.16, date 11.11.2004

Kerkues Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 34 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

Legjitimimi: Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jofitimprurëse, e njohur për aktivitetin e saj në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Ai është legjitimuar në paraqitjen e kërkesave analoge pranë Gjykatës Kushtetuese “për çështje që lidhen me interesat e tij”, kur konstatohet se pretendimet e parashtruara lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, gjë që sipas statutit të kësaj organizate përbën edhe objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

Perfundimi Rrezimi i Kërkeses

Ndikimi: Te dhenat financiare për te zgjedhurit dhe funksionaret publike nuk janë të dhena ngushtesisht personale dhe duhet të deklarohen për te luftuar fenomenet negative.

Vendim Nr. 26, date 02.11.2005

Kerkues Shoqata e Qiramarresve në shtepite shtetore ish-prone private

Objekti Shfuqizimi i nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, si antikushtetues.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Ndikimi: Eshtë shkelur parimi i sigurisë juridike....

Vendimi Nr.30, date 01.12.2005

Kerkues Shoqata Kombetare e të Shpronësuarve “Pronesi me Drejtesi”

Objekti Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i neneve 3.2, 3.5, 5, 6.1, 6.2, 7, 8.2, 8.3, 8.4, 9 dhe 13.2 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Legjitimimi: Nuk u diskutua

Perfundimi: Rrezimi i kërkeses

Ndikimi: Ish-pronaret e kanë humbur pronesinë e tyre mbi tokat. Kthimi i tyre nuk bazohet në të drejtën e pronësive, por në ndershmërinë dhe në shtetin social. Kthimi i tyre nuk duhet të shkaktojë padrejtësi të tjera.

Vendimi Nr.34, date 20.12.2005

Kerkues Shoqata Kombetare Antikomuniste e Ish të Perndjekurve Politike
Shoqata Mbarekombetare për Integrimin e të Burgosurve dhe të Perndjekurve Politike të Shqipërisë

Shoqata Kombetare e Ish të Dënuarve dhe të Perndjekurve Politike

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 1 të ligjit nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar.

Legjitimimi Kërkesit, shoqata që kanë si anëtarë ish-të burgosur dhe të përndjekur politikë dhe si synim kryesor mbrojtjen e interesave të tyre, legjitimohen në paraqitjen e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të dispozitës së mësipërme të ligjit nr.9260, datë 15.07.2004. Ato kanë interes të drejtpërdrejtë në rregullimin ligjor të problemeve që kanë të bëjnë me dëmshpërblimin, kompensimin dhe riintegrimin e kësaj kategorie personash në shoqërinë shqiptare. Ky fakt pasqyrohet edhe në statutin e të tre organizatave kërkuese.

Perfundimi Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 1 të ligjit nr.9260, datë 15.7.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar.

Ndikimi: Gjykata Kushtetuese e konsideron me rëndësi të theksohet se dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë për dëmin personal, për vuajtjet apo punën e papaguar të tyre gjatë regjimit të kaluar, nuk mund të bazohen në kuadrin ligjor të periudhës para tranzicionit. Prandaj e drejta e dëmshpërblimit dhe e kompensimit të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, pas përmbysejeve të rëndësishme politike e shoqërore që ndodhën edhe në vendin tonë, nuk mund të trajtohet si një e drejtë subjektive. Shteti demokratik i dëmshpërblen e kompenson këta persona sipas kushteve e mundësive ekonomike e financiare, duke u bazuar kryesisht në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe të barazisë.

Vendimi Nr.20, date 11.07.2006

Kerkues Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Grupi Shqiptar i te Drejtave te Njeriut

Objekti 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”; nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

2. Pezullimin e vendimeve të mësipërme të Këshillit të Ministrave.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”; nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ndikimi: Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë, në mënyrën se si është formuluar, nuk i ka lënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit si organ përfaqësues. Qëllimi i këtij neni është, që në rastin e kufizimeve, jo vetëm që duhet të respektohen kriteret e tjera të caktuara në të, por në mënyrë që garancitë të jenë sa më të plota, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht, organi më i lartë ligjvënës. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Rastin e delegimit të kompetencave Qeverisë për aktet me fuqinë e ligjit, Kushtetuta e ka shprehur në nenin 101 duke përcaktuar edhe kriteret përkatëse të një rregullimi të tillë, gjë që nuk e ka bërë në nenin 17.

Vendimi Nr.9, date 26.02.2007

Kërkues Shoqata Kombetare e Ushtarakeve ne Rezerve te Shqiperise

Objekti Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i neneve 1, 2 (pikat 5 e 6), 7 (shkronjat “a”, “b”) e 9 të ligjit nr.9481, datë 16.2.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Pranimi i kërkeses

Ndikimi: Respektimi i parimit të barazisë kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve në kushte të njëjta të shtetasve pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Vendimi Nr.11, date 04.04.2007

Kerkues Shoqata e Qeramarresve te Shtepive Shteterore Ish-Prone Private

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Ndikimi: Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe rregullimi ligjor i bërë nëpërmjet nenit 9 të ligjit objekt shqyrtimi, në esencë, ofron po ato alternativa që ofronte neni 9 i shfuqizuar, të cilat, me vendimin e sipërpërmendur, janë konsideruar jokushtetuese, sepse cenojnë parimin e sigurisë juridike, si dhe shkaktojnë diskriminim të një grupi.

Vendimi Nr. 35, date 10.10.2007

Kerkues Shoqata Kombetare e te Shpronesuarve “Pronesi me Drejtesi”

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me nenet 1, 2, 4, 11, 17, 18, 41, 42, 75, paragrafi i dytë, 78, paragrafi i dytë, 81 paragrafi i dytë, 82, paragrafi i parë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Legjitimimi Gjykata Kushtetuese përpara se të shqyrtojë pretendimet e palëve mbi thelbin e çështjes dhe të shprehet për pajtueshmërinë ose jo me Kushtetutën të ligjit të sipërcituar, çmon të domosdoshme të analizojë pretendimin e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave për moslegjitimitimin e kërkuarit lidhur me dispozitat që trajtojnë pronën publike dhe interesin e shtetit.

Çështjen e legjitimitit të kërkuarit, (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat (*organizatat e tjera*) janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre.

Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta. Në rastin konkret, shoqata “Pronësi me drejtësi”, sipas statutit, në fokus të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e interesave të ish-pronarëve, që janë zhveshur nga pronësia nëpërmjet shtetëzimeve, konfiskimeve dhe me çdo mënyrë tjetër nga regjimi totalitar, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike të pronarëve nga çdo cenim i të drejtës së pronësisë.

Gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar, se ligji objekt shqyrtimi, trajton probleme që lidhen me legalizime në vendbanime formale, zona informale, territore të tjera, si dhe të shtesave pa leje në ndërtime me leje; kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore ku është ngritur ndërtimi pa leje; urbanizim të zonave të blloqeve informale, të ndërtimeve informale dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial; procedurat e legalizimeve dhe ngritjen e strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre. Ky ligj rregullon jo vetëm problemin e legalizimit të ndërtimeve pa leje të ngritura mbi toka apo troje të pronarëve privatë, por dhe mbi toka e troje pronë publike.

Nga shqyrtimi i problematikës konstatohet se me interesat e kërkuessit kanë të bëjnë vetëm problemet e kalimit të pronës private tek ndërtuesit e paligjshëm dhe ajo pjesë e ligjit që trajton aspekte të urbanizimit të zonave të ndryshme që përfshihen në të, por që prekin pronën private.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuessit për antikushtetutshmërinë e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nuk mbart në vetvete interesin për t’u konsideruar në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si subjekt iniciues i gjykimit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike lidhur me çështje që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre. Kërkuessi legjitimohet vetëm për atë pjesë të ligjit që ka të bëjë me cenimin e interesave të pronarit të ligjshëm privat.

Pretendimi i përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave lidhur me moslegjitimitimin e kërkuessit për pjesën e dispozitave të ligjit që kanë të bëjnë me pronën publike është i drejtë.

Bazuar në përfundimin që ka të bëjë me pozitën që ka kërkuessi, sipas nenit 134, shkronja “g” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se duhet të nxjerrë në evidencë si objekt të kontrollit kushtetues, kryesisht nenet 15/1 e 2, 16/1, 17, 18, 19, 21, 25, 27, 28, 29, 30, 31 e 34 të ligjit të ankimuar.

Perfundimi Rrezimi i Kerkeses

Ndikimi: Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk është detyrë e kësaj Gjykate shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën.

Vendimi Nr.41, date 16.11.2007

Kerkues Organizata Kombetare « Per Deshmoret e Luftes Antifashiste Nacionalclirimtare dhe te Deshmoreve te tjere te Atdheut ».

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”.

Legjitimimi Nuk u diskutua

Perfundimi Rrezimi i Kerkeses

Ndikimi: Gjykata Kushtetuese vlerëson se dhënia e së drejtës për të bërë propozim për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” edhe prefektit nuk cenon parimet kushtetuese e ligjore që rregullojnë qeverisjen vendore, pasi njohja e Statusit të Dëshmorit të Atdheut është një çështje me rëndësi jo vetëm lokale, por edhe kombëtare, e cila, në disa raste, mund të zgjidhet më mirë me iniciimin e procesit nga organet e pushtetit qendror, përfaqësues i të cilëve është prefekti.

Nga ana tjetër, dhënia e kompetencës për të bërë propozim për shpalljen “dëshmor” edhe prefektit nuk kufizon kompetencat e organeve të pushtetit vendor. Kjo e drejtë zgjeron vetëm rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të iniciojnë një procedurë administrative për njohjen e këtij statusi nga Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, i cili mbetet i vetmi organ vendimmarrës.

Vendimi Nr.9, date 19.03.2008

Kerkues Konferenca e Rektoreve
Qendra Forumi i Mendimit te Lire

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i fjalisë së tretë të pikës 1 të nenit 23 dhe pikave 2 dhe 3 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”

Legjitimimi Gjykata Kushtetuese, nisur nga pretendimet e paraqitura prej subjekteve të interesuara lidhur me legjitimitimin e kërkuessve, çmon të nevojshme që përpara se të marrë në shqyrtim objektin e kërkesës, të shprehet nëse kërkuessit bëjnë pjesë në rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Rrethi i këtyre subjekteve përcaktohet në

nenin 134 të Kushtetutës. Në pikën 1, shkronja “f”, të kësaj dispozite thuhet shprehimisht se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të partive politike dhe organizatave të tjera, por kjo e drejtë u është dhënë e kufizuar, sepse sipas pikës 2 të po këtij neni të Kushtetutës, këto subjekte mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Problemi i legjitimitetit të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, është vlerësuar prej saj si një element i rëndësishëm i inicimit të procesit kushtetues. Në gjykimet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, për të legjitimuar subjektet iniciuese, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar paraprakisht që ato të provojnë nëse janë subjekte që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nëse çështja kushtetuese e paraqitur për shqyrtim ka lidhje me interesat e tyre. Në plotësim të këtyre kërkesave, Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar organizatat si subjekte që ushtrojnë të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre.

Konferenca e Rektorëve, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, është një organ kolegjal i pavarur i autoriteteve drejtuese të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, që kryen veprimtari në fushën e zhvillimit, koordinimit dhe të kërkimit shkencor të arsimit të lartë. Ajo, duke pasur në thelb karakterin e një organizate me anëtarësi, gjatë veprimtarisë së saj, shpreh opinione për probleme të respektimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, ose për çdo problem tjetër kur e gjykon të nevojshme, si dhe mban lidhje me shoqata homologe për nxitjen e shkëmbimeve universitare që ndihmojnë në përparimin e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor. Nisur nga lidhja që ekziston ndërmjet objektit të veprimtarisë së Konferencës dhe çështjes së paraqitur për shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konkludon se Konferenca e Rektorëve legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj para Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1 shkronja “f”, dhe pikës 2 të Kushtetutës.

Qendra “Forumi i Mendimit të Lirë” është një organizatë jofitimprurëse, që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit në fuqi. Objekti i veprimtarisë së kësaj organizate, i parashikuar në statut, është dhe nxitja e zhvillimit të legjislacionit në fushën e arsimit, mbrojtja e interesave të ndryshme të institucioneve arsimore të çdo niveli, respektimi i parimit të autonomisë universitare, si dhe promovimi i edukimit shoqëror e individual, bazuar në vlerat e demokracisë liberale.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se objekti i veprimtarisë së kësaj organizate jofitimprurëse lidhet me çështjet kushtetuese të ngritura prej saj në kërkesën për gjykim, çka e legjitimon edhe këtë subjekt për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson të drejtë pretendimin e subjekteve të interesuara lidhur me moslegjitimitetin e rektorëve të universiteteve për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Në bazë të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, rektori është autoritet drejtues i institucionit të arsimit të lartë dhe si i tillë, ai nuk përfshihet në radhën e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1, të Kushtetutës. Në këto kushte, rektori nuk ka të drejtë që t’i drejtohet kësaj Gjykate për çështje që kanë të bëjnë me gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës.

Perfundimi Pranimi pjesërisht i kërkesës.

Vendimi Nr.10, date 19.03.2008

Kerkues Lidhja e Biznesmeneve te Lojrave Elektronike

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 2, pika 3, të ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar.

Legjitimimi: Nuk u diskutua

Perfundimi Rrezimi i Kërkeses

Ndikimi: Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që para se t'i japë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, të ndalet në konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës.

Vendimi Nr.16, date 25.07.2008

Kerkues Dhoma Amerikane e Tregtise ne Shqiperi
Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise
Konfindustria/Konfederata e Industrive te Shqiperise
Shoqata e Hidrokarbureve
Shoqata e Investitoreve te Huaj ne Shqiperi
Dhoma e Tregtise dhe Industrise Shqiptaro – Britanike
Dhoma Greko – Shqiptare e Tregtise dhe Industrise

Objekti Shfuqizimi i pikës 2, të nenit 3, të Ligjit nr.9713, datë 16.04.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Legjitimimi Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, pretendon se kërkuarit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në kuptim të nenit 134, pika 1, germa “f” të Kushtetutës, pasi nuk kanë provuar përfshirjen e tyre në rrethin e “organizatave të tjera” që parashikon kjo dispozitë. Sipas mendimit të subjektit të interesuar, neni 46 i Kushtetutës bën një ndarje të qartë midis organizatës dhe shoqatës. Po ashtu neni 9 dhe neni 131/d i Kushtetutës i referohen organizatave me karakter politik duke i vendosur ato krahas partive politike, ndërsa përta i përket nenit 134/f të Kushtetutës, në rast se qëllimi i ligjvënësimit nuk ka qenë për përfshirjen e organizatave me karakter politik, atëherë me siguri që organizatat do të ishin listuar në një gërmë të veçantë dhe jo në të njëjtën gërmë me partitë politike.

Lidhur me pretendimin e mësipërm Gjykata Kushtetuese vlerëson, se në “organizatat e tjera” të cilat, sipas nenit 134, pika 1, germa “f”, të Kushtetutës janë subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përfshihen edhe organizatat që nuk kanë karakter politik. Ky konkluzion gjën mbështetje dhe në interpretimin e një sërë dispozitash të tjera të Kushtetutës, ku gjejmë të përmendur termin “organizatë”. Kështu, Kushtetuta u njeh individëve të drejtën të organizohen në parti apo organizata të tjera politike (neni 9); të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të pakicave kombëtare (neni 20); të drejtën të organizohen kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm (neni 46); të drejtën e të punësuarve të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës (neni 50), mjafton që organizatat ose shoqatat të mos ndjekin qëllime antikushtetuese (neni 46). Kjo dispozitë (neni 46) e referuar si bazë nga subjekti i interesuar për të mbështetur pretendimin e tij, megjithëse ka vendosur lidhësen “ose” midis organizatave dhe shoqatave, nuk mund të interpretohet e shkëputur nga dispozitat e tjera kushtetuese. Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton, se ligjvënësi kushtetues me termin “organizatë” ka dashur ti referohet, në një kuptim më të gjerë, shoqatave, fondacioneve apo çdo organizimi tjetër, aktiviteti i të cilave mund të ketë qëllime politike, ekonomike, sociale, apo çdo qëllim tjetër të ligjshëm. Prandaj, nuk mund të pranohet që organizatat e vendosura pranë partive politike në nenin 134/f të Kushtetutës janë vetëm të karakterit politik. Ligjvënësi kushtetues, duke i vendosur organizatat e tjera krahas partive politike në nenin 134/f, nuk ka patur për qëllim të pranojë si subjekte inicuese vetëm organizatat me karakter politik, por të përfshijë në rrethin e “organizatave të tjera” të gjitha ato shoqata, fondacione, sindikata apo organizime të tjera me karakter të ndryshëm, duke përfshirë edhe ato me karakter politik, që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore. Pra ligjvënësi kushtetues, ka patur për qëllim të zgjerojë kategorinë e subjekteve që mund të drejtohen Gjykatës Kushtetuese, duke mos i kufizuar ato subjekte vetëm në shoqata, dhe as vetëm të karakterit politik, por duke i përcaktuar me termin e përgjithshëm “organizata”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka legjitimuar disa herë organizatat si subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (vendimet nr.9/2007; nr.11/2007;

nr.35/2007; nr.41/2007; nr.9/2008, etj.). Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, kërkuesit janë organizata që mbrojnë interesat ekonomikë të anëtarëve të tyre, persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në vend. Veçanërisht kuadri ligjor i procedurave tatimore, detyrimet tatimore, pagesa e tyre, gjobat dhe interesat si dhe procedurat e ankimit, paraqesin rëndësi për tatimpaguesit, pasi këto dispozita ligjore ushtrojnë një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin e tyre ekonomik. Në këtë kuptim, dispozita e atakuar (neni 3/2 i Ligjit 9713) ka të bëjë drejtpërsëdrejti me lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të shoqatave kërkuese. Në këto kushte mund të konkludohet, se kërkuesit kanë interes për të kundërshtuar nenin 3/2 të Ligjit 9713.

Përsa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson, se kërkuesit legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 134, shkronja “f”, të Kushtetutës.

Perfundimi Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 2, të nenit 3, të Ligjit nr.9713, datë 16.04.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Ndikimi: Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë nëse neni 41 (e drejta e pronës) i Kushtetutës është i zbatueshëm në rastin në shqyrtim.

Vendimi Nr. 17, datë 25.07.2008

Kerkues Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 15.8.2007 “Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”:

- të frazës “ose privatë” në rreshtin e dytë dhe të frazës “ose private” në fjalinë e tretë të paragrafit të dytë;

- të frazës “ose privat” në rreshtin e parë dhe të frazës “apo private” në rreshtin e dytë të paragrafit të nëntë;

- të lidhëses “e” përpara frazës “... që marrin pjesë në tendera ...” në rreshtin e dytë të paragrafit të dhjetë;

- të paragrafit të trembëdhjetë.

Legjitimimi Përfaqësuesi i subjektit të interesuar ka pretenduar se Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë nuk është “organizatë” në kuptim të nenit 134 shkronja “f” të Kushtetutës, sepse në këtë term përfshihen vetëm organizatat me karakter politik. Shoqata në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës barazohet me individin dhe si e tillë mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese vetëm për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

2. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet në kuptim të nenit 134, shkronja “f” të Kushtetutës dhe nenit 49/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.38, datë 12.01.2001. Në Statutin e Shoqatës, neni 5 parashikohet se qëllimi i shoqatës është, ndër të tjera, “mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave të shoqërive të ndërtimit...” dhe se ajo mund të reagojë “me mjete ligjore ndaj akteve që shkelin të drejtat kushtetuese e ligjore të anëtarëve të shoqatës”.

Çështjen e legjitimitetit të kërkuesit, (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

Shoqatat (organizatat e tjera) janë të specifikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “g “ të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007).

Gjykata konstaton se vënia në dyshim prej subjektit të interesuar e legjitimitetit të kërkuesit, me arsyetimin se në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, në frazën “*organizata të tjera*” ka përfshirë vetëm ato me karakter politik, duke sjellë si argument nenin 9, paragrafi 2 dhe neni 131, shkronja “f” të Kushtetutës, është një pretendim i pabazuar. Neni 134 i Kushtetutës, duke listuar subjektet që legjitimohen të investojnë Gjykatën, në shkronjën “f” përmend shprehimisht “*partitë politike dhe organizatat e tjera*”. Termi “*organizatë*” në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është përmendur në disa konotacione, në analizë literale-gramatikore të të cilave rezulton se kushtetutbërësi me *organizatë*, në kuptimin e përgjithshëm, ka kuptuar ato *politike* (neni 131, shkronja “d”), *etnike, kulturore, fetare, gjuhësore* (neni 20/2), *sindikale* (neni 50), *shoqërore, ekonomike, tregtare* (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2).

Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit “*organizatë*” edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve (shtetas shqiptarë a të huaj), me kushtin që organizimi i tyre të përputhet me parimet demokratike, ndërsa programet dhe veprimtaria e tyre të mos mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si dhe të mos jenë me karakter të fshehtë (neni 9/2 i Kushtetutës).

3. Gjykata çmon, se kuptimi mbi legjitimitimin duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të së drejtës për *veprimtari të lirë ekonomike* (neni 11 i Kushtetutës) nga pretendimi për *antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimit kushtetues të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës*.

Në lidhje me të dy pretendimet, Gjykata vlerëson se meqenëse gjendemi përpara *kontrollit abstrakt* të kushtetutshmërisë së normës, është e nevojshme të analizohet pretendimi i subjektit të interesuar për mungesën e legjitimitetit të kërkuesit, në kuptim të nenit 11 dhe 118 të Kushtetutës.

Gjykata çmon, se procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, *për arsye të një interes publik* qoftë dhe *pa patur një interes konkret subjektiv*, vetëm autoritete të larta shtetërore, (subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të Kushtetutës). Pra, kushtetutbërësi ka legjitimuar për të vënë në lëvizje Gjykatën në lidhje me *kontrollin abstrakt* të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e parë të listuar në pikën 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por për një ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Mbi këtë bazë, të gjithë subjektet e tjerë, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f”, dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të *kontrollit konkret* të kushtetutshmërisë së normës juridike.

Problemi i legjitimitetit të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën, është vlerësuar prej jurisprudencës së saj si një aspekt i rëndësishëm i procesit kushtetues. Në gjykimet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, për të legjitimuar subjektet iniciues, Gjykata ka kërkuar paraprakisht që ato të provojnë nëse janë subjekte që parashikohen në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës dhe nëse çështja kushtetuese e paraqitur për shqyrtim ka lidhje me interesat e tyre. Në plotësim të këtyre kërkesave, Gjykata i ka konsideruar organizatat si subjekte që ushtrojnë të drejtën për një gjykim kushtetues, duke patur legjitimitet vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre (Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.03.2008).

Nga kjo pikëpamje, për çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon se është e domosdoshme të analizohet legjitimiteti (*ratione materiae*) i kërkuesit në lidhje me pretendimin e tij për antikushtetutshmërinë e Vendimit të Këshillit të Ministrave, me argumentin se nuk është nxjerrë në përputhje me kriteret e parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës.

Përsa i përket legjitimit të subjekteve, të cilëve u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Pra interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit.

Pra, Gjykata thekson se, vetëm nëse e përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2, i nenit 134 të Kushtetutës, për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”, edhe subjektet e listuara në pikat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” të nenit 134/1 mund t’i drejtohen Gjykatës në lidhje me prerogativën e saj për të vendosur mbi “pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare” (neni 131/c i Kushtetutës).

Në rastin në shqyrtim, kërkuesi pretendon se Vendimi i Këshillit të Ministrave cenon kriteret e parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës, sepse ligjet në bazë e për zbatim të të cilëve ka dalë, nuk e autorizojnë organin për nxjerrjen e këtij akti nënligjor dhe nuk përcaktojnë as çështjet që duhen rregulluar prej tij. Në këtë mënyrë, ndonëse kjo dispozitë kushtetuese është më tepër një dispozitë e karakterit procedural, e meta e pretenduar prej kërkuesit është e aspektit material, sepse sipas kërkuesit, Këshilli i Ministrave nuk është autorizuar nga ligjvënësi të nxjerrë një normë të tillë nënligjore dhe se ai ka operuar në tejkalim të pushtetit të dhënë përmes këtyre ligjeve, duke nxjerrë këtë akt nënligjor për qëllime të ndryshme nga ato të treguara nga norma që ia atribuon këtë të drejtë.

Pikërisht, parashtrimin e një pretendimi të tillë që i përket natyrës së një gjykimi abstrakt të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës juridike prej një subjekti, që e ka të kushtëzuar inicimin e gjykimit kushtetues me të provuarin e interesit për çështjen, Gjykata e çmon të nevojshme ta vlerësojë në drejtim të cenimit ose jo të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Perfundimi Rrëzimin e kërkesës.

Ndikimi: Gjykata e ka analizuar në disa linja kryesore konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Kjo liri, në kuptim të nenit 11/3 të Kushtetutës mund të kufizohet vetëm *me ligj* dhe vetëm për *arsye të rëndësishme publike*.

Vendimi Nr. 25, datë 29.07.2008

Kerkues Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë,

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 9399, datë 12.05.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”.

Legjitimimi Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e vlerëson të nevojshme të analizojë paraprakisht legjitimitimin e Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e ka argumentuar mungesën e legjitimitimit të kërkuesit në këtë gjykim kushtetues, për shkak të subjektit konkret që ai përfaqëson (*ratione personae*), për shkak të kalimit të afatit 3 vjeçar për të paraqitur kërkesën (*ratione temporis*), si dhe për shkak të mungesës së lidhjes ndërmjet interesit të tij të drejtpërdrejt me thelbin e çështjes në gjykim (*ratione materiae*).

2. Në kuptim të rregullimit të parashikuar nga nenet 131, shkronja “a” dhe 134, pika 2, shkronja “f” të Kushtetutës, kërkuesi legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet për këtë çështje Gjykatës Kushtetuese. Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve është regjistruar si subjekt juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2160, datë 25.01.2008. Në nenin 1 të Statutit të Shoqatës është parashikuar, si një ndër qëllimet kryesore të saj, “konsolidimi, forcimi dhe mbrojtja e pavarësisë së gjiqtarëve dhe të sistemit gjyqësor në tërësi”.

Kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve, e paraqitur nga kryetarja e saj, në kuptim të kompetencës që parashikohet në nenin 10 të Statutit, përmban si argument parësor, që Gjykata e konsideron të përfshirë në sferën e qëllimit të kësaj Shoqate, pretendimin për cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve e, në veçanti, të parimit të pavarësisë së gjyqësorit,

që kanë të bëjnë me rolin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare si institucioni që zgjedh shumicën absolute të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* pasi kërkesa është regjistruar brenda afatit të parashikuar në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ligji, objekt shqyrtimi, është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 14.06.2005. Vetë ligji, në nenin 12 të tij, përcakton se “ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Rezulton se ky afat 15 ditor është plotësuar në datën 29.06.2005. Sipas një vërtetimi me nr. *extra*, datë 04.07.2008 të lëshuar nga Dega e Shërbimeve të Filialit të Postës Shqiptare, Tiranë dhe të administruar në këtë gjykim kushtetues rezulton se kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve, me “nr. 7283 është pranuar në sportelin e Postës Qendër-Tiranë në datën 27.06.2008”.

Në nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se kërkesat për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre”. Në nenin 1, paragrafi 2, të ligjit është sanksionuar rregull se “për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”. Në këtë kontekst, neni 149 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se “afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit”.

4. Pa i hyrë paraprakisht analizës mbi pajtueshmërinë e ligjit, objekt shqyrtimi, me Kushtetutën, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e tij për antikushtetutshmërinë e ligjit, në këndvështrim të nenit 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës.

Në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, çështjen e legjitimitetit të kërkuetit, Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që përcakton inicimin e procesit kushtetues. Për gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në dispozitën e sipërcituar, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe pretendimit për shkelje kushtetuese në çështjen e ngritur. Shoqatat (organizatat e tjera) janë parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 10.10.2007 dhe nr. 17, datë 25.07.2008*).

Për të vlerësuar legjitimitetin e subjektit, të cilit i kërkohet të justifikojë interesin e tij në lidhje me çështjen, Gjykata duhet të përcaktojë të drejtën kushtetuese ose ligjore të subjektit, i cili pretendon se i është cenuar për shkak të antikushtetutshmërisë së normës konkrete të kundërshtuar para saj.

Neni 81, pika 2, shkronja “a”, i Kushtetutës, që kërkuesi pretendon të jetë shkelur nga ligji objekt shqyrtimi, është normë kushtetuese me karakter procedural. Në jurisprudencën kushtetuese është argumentuar se subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës nuk legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike duke paraqitur si argument ekzistencën e veseve formale, në qoftë se vetë norma nuk ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t’i mbrojë para Gjykatës. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi pretendon se ligji i kundërshtuar ka cenuar, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe, në veçanti, me pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Në jurisprudencën e kësaj Gjykate është theksuar se “deklarimet e neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës shprehen në funksion të garantimit të pavarësisë së organeve dhe institucioneve kushtetuese. Sipas nenit 6, organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohet me ligjet e tyre përkatëse...”, ndërsa në nenin 81, pika 2, shkronja “a” theksohet, ndër të tjera, se ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të

parashikuara nga Kushtetuta duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit... Kjo pavarësi nuk është thjesht një privilegj i tyre, por një prerogativë e vërtetë dhe e domosdoshme, e cila u jep më shumë siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet organeve dhe institucioneve kushtetuese në ushtrimin e detyrave të tyre” (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007*).

Pavarësisht se në formë, neni 81, pika 2, shkronja “a” i Kushtetutës, është normë me natyrë procedurale, në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Kjo dispozitë kushtetuese është edhe në funksion të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe pretendimi për cenimin e kësaj prerogative procedurale, i ngritur pikërisht nga një subjekt, i cili në veprimtarinë ligjore ka një mision të tillë, e bën të pranishëm ekzistencën e interesit për çështjen në shqyrtim. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve legjitimohet *ratione materiae* të kërkojë kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën.

Perfundimi Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.9399, datë 12.05.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare”.

Ndikimi: Për t’i dhënë zgjidhje të drejtë pretendimeve të subjekteve në këtë proces kushtetues, Gjykata e çmon të nevojshme të bëjë interpretimin në nenin 81, pika 2, shkronja “a” të termit “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*”, si dhe të vendit që zë Konferenca Gjyqësore Kombëtare, në kuptim të nenit 147 të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se neni 81, pika 2, shkronja “a” dhe veçanërisht termi “*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*” duhet të interpretohet në lidhje dhe me nenin 6 të Kushtetutës, që përdor termin “*organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë*”.

Vendimi Nr. 12, date 28.04.2009

Kerkues Shoqata e Shoqerive të Hidrokarbureve

Objekti: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, të Udhëzimit nr.18, date 18.06.2008 të Ministrit të Financave, për disa shtesa në Udhëzimin nr.17, date 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Legjitimimi Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka interpretuar, kriteret kushtetuese për legjitimitimin e organizatave si subjekte që mund ta venë atë në lëvizje (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9/2007; nr.11/2007; nr.35/2007; nr.41/2007; nr.9/2008*). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, date 10.10.2007*). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë I sigurt, I drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve është një person juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.810, date 28.10.2003. Anëtarët e shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e Shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor I shoqatës është: “*përfaqësimi, dhe mbrojtja e interesave të përbashkëta të anëtarëve në kuadrin e zhvillimit të tregut të hidrokarbureve*”. Kërkuesi është organizatë që mbron interesat ekonomike të anëtarëve të tij, të cilët janë persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në tregun e hidrokarbureve. Veçanërisht kuadri ligjor tatimor që lidhet me tregun e hidrokarbureve dhe që është rregulluar me skemë të veçantë sipas Udhëzimit nr.18, date 18.06.2008 të Ministrit të Financave paraqet rëndësi për këta tatimpagues, pasi këto dispozita ligjore ushtrojnë një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik të anëtarëve të shoqatës. Në këtë kuptim, pika 1 e Udhëzimit nr.18, e cila përcakton regjimin e furnizimit të karburanteve dhe në veçanti llojin e furnizimeve dhe furnizuesve si kryesorë dhe si

agjentë në treg, ka lidhje të drejtpërdrejtë me veprimtarinë ekonomike të anëtarëve të shoqatës kërkuese.

Perfundimi Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të Udhëzimit nr.18, date 18.06.2008.

Vendimi Nr.20, date 09.07.2009

Kerkues Shoqata Kombetare e Gjuqtareve

Objekti: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 37/2; 38/a, b të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Legjitimimi 1. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi, parashitroi se kërkuesi nuk legjitimohet në këtë gjykim kushtetues, për shkak të subjektit konkret që ai përfaqëson (*ratione personae*), si dhe për shkak të mungesës së lidhjes ndërmjet interesit të tij të drejtpërdrejtë me thelbin e çështjes në gjykim (*ratione materiae*).

2. Kërkuesi pretendoi se legjitimohet në kërkesën e tij, sipas objektit të këtij gjykimi kushtetues, për arsye se neni 134, shkronja “f” e Kushtetutës parashikon, se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nga organizata të tjera. SHKGGJ, sipas Statutit të saj, synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor.

3. Gjykata vëren, se në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “f” e Kushtetutës, kërkuesi legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për arsye se SHKGGJ është një organizatë në kuptimin që e përdor neni i sipërcituar i Kushtetutës, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2160, datë 25.01.2008. Në nenin 1 të Statutit të Shoqatës është parashikuar, se një ndër qëllimet kryesore të saj është “konsolidimi, forcimi dhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqtarëve dhe e sistemit gjyqësor në tërësi”.

4. Kërkuesi legjitimohet *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e tij për antikushtetutshmërinë e neneve të kundërshtuara të ligjit, objekt shqyrtimi, në këndvështrim të neneve 7 dhe 145, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës.

Gjykata ka theksuar edhe më parë se, në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, për gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve normative, subjektet që parashikohen në këtë dispozitë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe pretendimit për shkelje kushtetuese në çështjen e ngritur. Shoqatat (organizatat e tjera) janë parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007 dhe nr.17, datë 25.07.2008*). Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit, Gjykata përcakton fillimisht të drejtën kushtetuese të subjektit, që pretendohet se i është cenuar nga norma konkrete e kundërshtuar para saj. Subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike në qoftë se vetë norma ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t’i mbrojë para Gjykatës Kushtetuese. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi pretendon se ligji i kundërshtuar ka cenuar, në përmbajtje, standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe, në veçanti, me pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqësorit është element thelbësor dhe një ndër arsyet e themelimit të SHKGGJ-së. Duke qenë se ekziston lidhja e domosdoshme ndërmjet veprimtarisë që kërkuesi kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur prej tij, kjo shoqatë legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese lidhur me pretendimet e paraqitura para saj në objektin e kërkesës.

Perfundimi - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shprehjes në nenin 38, shkronja “a” të ligjit nr.9877: “a) emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës”;

- Rrëzimin e kërkesës lidhur me pretendimin për jokushtetutshmërinë e shprehjes në nenin 38, shkronja “b” të ligjit nr.9877: “*b) mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar*”.

- Refuzimin e kërkesës lidhur me pretendimin për jokushtetutshmërinë e shprehjes në nenin 37, pika 2, të ligjit nr.9877 : “*Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë*”.

Vendimi Nr.24, date 24.07.2009

Kerkesues Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve

Objekti Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë.”

Legjitimimi Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimitimin e organizatave si subjekte që mund ta vënë atë në lëvizje (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9/2008, 41/2007, 35/2007, 11/2007, 9/2007*). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Gjykata Kushtetuese ka çmuar, se kuptimi mbi legjitimitimin duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të së drejtës për veprimtari të lirë ekonomike (neni 11 i Kushtetutës) dhe pretendimit për antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimit kushtetues të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.07.2008*).

Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.810, datë 28.10.2003. Anëtarët e shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e Shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor i shoqatës është “... përfaqësimi, dhe mbrojtja e interesave të përbashkëta të anëtarëve në kuadrin e zhvillimit të tregut të hidrokarbureve”. Kërkesuesi është organizatë që mbron interesat ekonomike të anëtarëve të saj, të cilët janë persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në tregun e hidrokarbureve. Ai pretendon se vendimi, objekt i këtij gjykimi pranë Gjykatës Kushtetuese, krijon një diskriminim *in favorem*, në favor, të produktit Diezel D1 i prodhuar nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kundrejt atij të importuar nga anëtarët e kërkuarit. Gjithashtu, kërkesuesi pretendon se vendimi objekt shqyrtimi, dëmton interesat ekonomike të anëtarëve të tij nëpërmjet krijimit të një monopoli të përkohshëm duke lejuar vetëm tregtimin e lëndës djegëse Diezel D2 të prodhuar nga shoqëria ARMO sh.a. Për këto arsye vendimi nr.52, datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave ndërhyr drejtpërdrejtë në fushën e aktivitetit ekonomik të anëtarëve të kërkuarit, duke karakterizuar kështu lidhjen e drejtpërdrejtë me lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të kësaj shoqate.

Perfundimi Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diezel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë”.

Ndikimi: Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar duke lejuar tregtimin e të njëjtit produkt me sasi të ndryshme squfuri, duke lejuar tregtimin e një produkti nga shoqëria ARMO të ndaluar

për operatorët e tjerë dhe, duke i imponuar subjekteve tregtare që janë anëtare të kërkuesit dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të pajisura me “leje tregtimi të llojit A”, blerjen e produktit Diezel D2 pranë një operatori të vetëm, nëse duan që këtë produkt të vazhdojnë të shesin, krijon në treg një monopol në favor të shoqërisë ARMO sh.a. dhe për pasojë, cenon lirinë e importimit dhe eksportimit të mallrave dhe shërbimeve, duke kufizuar kështu lirinë e tyre ekonomike.

Vendimi Nr.26, date 24.07.2009

Kerkues Unioni i Gjyqtareve të Shqiperise

Objekti: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i fjalisë “Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë” dhe i fjalisë “Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind”, të nenit 26/2, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Legjitimimi Subjektet e interesuar Kuvendi i Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë kanë pretenduar se kërkuesi nuk duhet të legjitimohet pasi ai nuk ka tagër të flasë në emër të të gjithë gjyqtarëve dhe, se ligji i kundërshtuar nuk cenon interesat e tij. Çështjen e legjitimitetit të kërkuesit, (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, që përfshihen në subjektin kushtetues “organizatat e tjera” janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta.” (*Shih vendimin nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, shkronja “f” të Kushtetutës dhe neni 49, pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ai është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2171 datë 04.02.2008. Në Statutin e Shoqatës, neni 1 parashikon se, “Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare”. Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të zakonshëm. Gjithashtu, neni 8 i Statutit të kësaj Shoqate parashikon se, “Duke bashkuar gjyqtarët, shoqata ka për qëllim të ndihmojë në mbrojtjen e interesave të tyre ... materiale; të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv”.

Perfundimi Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të fjalisë “Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë” dhe të fjalisë “Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind”, të nenit 26/2, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndikimi: Gjykata vlerëson se gjyqtarët duhet të marrin pagesë për shërbimin e tyre në një nivel të përshtatshëm në raport me pagën e zyrtarëve të tjerë publikë, e cila duhet të jetë në përpjesëtim me statusin e tyre dhe e paprekshme për sa kohë që ata janë duke ushtruar detyrën e gjyqtarit.

Vendimi Nr.31, date 02.12.2009

Kerkues Unioni i Gjyqtareve te Shqiperise

Objekti:Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i dy fjalive të para, paragrafi i dytë, i nenit 24 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që sanksionon se: “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht”.

Legjitimimi: Gjykata Kushtetuese (Gjykata) përpara shqyrtimit të pretendimeve të kërkesit, vlerëson të analizojë pretendimet e parashtruara nga subjektet e interesuara lidhur me legjitimimin e kërkesit në këtë gjykim kushtetues.

Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë ka pretenduar se Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (Unioni) nuk përfaqëson të gjithë gjyqtarët dhe kërkesa e tyre nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të gjyqtarëve.

Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë ka pretenduar se Unioni nuk është “organizatë” në kuptim të nenit 134, shkronja “f” të Kushtetutës, sepse në këtë term përfshihen vetëm organizatat me karakter politik. Shoqata, në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, barazohet me individin dhe si e tillë, mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese vetëm për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Çështjen e legjitimitit të kërkesit, Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në “... organizata të tjera” të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës. Në kategorinë e “organizatave të tjera” është vlerësuar se përfshihen organizatat politike (neni 131, shkronja “d”), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2). Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit “organizatë” edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve (shtetas shqiptarë a të huaj), me kushtin që organizimi, programet dhe veprimtaria e tyre të përputhen me parimet demokratike të shtetit të së drejtës (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 25.07.2008*).

Në vështrim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 19.03.2008 dhe nr. 17, datë 25.07.2008*).

Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se është e domosdoshme të analizojë nëse Unioni është një nga subjektet që vë në lëvizje Gjykatën në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës. Në këtë vështrim, Gjykata konstaton se Unioni është person juridik (shoqatë) i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2171, datë 04.02.2008. Në nenin 8 të statutit të Unionit parashikohet, se qëllimi i veprimtarisë së tij është, ndër të tjera: “... të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe përsosjen e konsolidimit e pozitës së balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv dhe të ndihmojë në mbrojtjen e interesave profesionale, intelektuale, etike, shoqërore dhe materiale të gjyqtarëve.”

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Unioni përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Ndryshe nga sa pretendojnë përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë, kërkesi është subjekt i legjitimuar *ratione personae*.

Kërkesi ka iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt, dhe sipas kërkesave të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, për t’u legjitimuar *ratione materiae* ka detyrimin të provojë interesin e tij

me çështjen, pra lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet misionit që ka dhe pasojave që vijnë nga zbatimi i dy fjalive të para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

Gjykata vëren se norma e kundërshtuar (neni 24) rregullon numrin e ditëve dhe shtrirjen kohore të lejes vjetore të pagueshme. Ky nen, i cili përcakton një nga aspektet e statusit të gjyqtarëve është formuluar në interes të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Ndërkohë, misioni i Unionit ka në fokus të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave profesionale dhe materiale të gjyqtarëve, në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Si rrjedhim, Gjykata vëren se ekziston lidhja e domosdoshme midis misionit të kërkuarit dhe normës së kundërshtuar, prandaj Unioni legjitimohet *ratione materiae*.

Përsa i përket pretendimit të subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, se Unioni nuk legjitimohet pasi nuk përfaqëson të gjithë gjyqtarët dhe se kërkesa nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të gjyqtarëve, Gjykata e vlerëson atë të pabazuar. Për efekt të legjitimitetit nuk është e nevojshme që Unioni të provojë se përfaqëson të gjithë gjyqtarët, apo kërkesa e tij të mbështetet edhe nga shoqatat e tjera, pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, i cili përcakton rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimitetin.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se, mbështetur në nenin 134, pika 1 shkronja “f” dhe 134, pika 2 të Kushtetutës, Unioni legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë të dy fjalive të para të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

Perfundimi Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dy fjalive të para, paragrafi i dytë, i nenit 24 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me përmbajtje: “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht”.

Vendimi:	Nr. 3, datë 05.02.2010
Kerkues:	Organizata Profesionale e Ekonomisteve
Objekti:	1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Ligjit nr.10091, dt. 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” 2. Pezullimi i Ligjit nr.10091, dt. 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” 3.Papajtueshmëria me Kushtetutën e VKM nr.150, dt.31.03.2000 të ndryshuar me VKM nr.625, dt.12.11.2001.

Legjitimiteti: Çështjen e legjitimitetit të kërkuarit, (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, që përfshihen në subjektin kushtetues “organizatat e tjera” janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre.

Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta.” (Shih vendimet nr.35, datë 10.10.2007; nr.25, dt.05.12.2008; nr.17, dt.25.07.2008; nr.31, dt.02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese)

Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, shkronja “f” të Kushtetutës dhe neni 49, pika 2 i Ligjit nr. 8577, datë

10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Duke qenë se ligji objekt shqyrtimi përcakton, përveç të tjerave, edhe rregullat për ushtrimin e profesionit të anëtarëve të organizatës që përfaqëson kërkuesi, Gjykata çmon se ai ka interes të drejtpërdrejt në paraqitjen e kërkesës para saj për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji dhe për këtë arsye legjitimohet në kërkimet e tij.

Perfundimi: Shfuqizimin e nenit 58 të Ligjit nr.10091, dt.05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” .

- Rrëzimin e kërkesës për pjesët e tjera.

Ndikimi: Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim nuk është i bazuar dhe duhet rrëzuar. Nëse do t’i referohemi direktivës së BE-së mbi kontrollin (auditin) ligjor në vendet e BE-së, në nenin 32 të saj, thuhet: “Shtetet anëtare duhet të organizojnë një sistem efektiv të mbikëqyrjes publike të ekspertëve kontabël dhe firmave që kryejnë audit, bazuar në parimet e parashikuara në pg.2-7. Të gjithë ekspertët kontabël duhet t’i nënshtrohen kontrollit. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të drejtohet nga jopraktikantë, të cilët kanë mjohuri nga fusha ose fusha të ngjashme me auditin. Anëtarët e autoritetit të mbikëqyrjes publike zgjidhen nëpërmjet një procedure të pavarur dhe transparente²²”.

Vendimi: Nr. 4, 12.02.2010

Kerkues: Shoqata e ish te burgosurve politike te Shqiperise
Shoqata kombetare e debim internimeve politike te Shqiperise.

Objekti: Shfuqizimi si antikushtetues i Ligjit nr. 9831, 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”.

Legjitimimi: Çështjen e legjitimitit, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në “... organizata të tjera” të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, duke përfshirë organizatat politike (neni 131, shkronja “d”), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2). Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që I duhet dhënë termi “organizatë” edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve, me kushtin që organizimi, programet dhe veprimtaria e tyre të përputhen me parimet demokratike të shtetit të së drejtës (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, 25.07.2008)

Gjithashtu, në vështrim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen të papajtueshme me Kushtetutën. Gjykata vlerëson, se kërkuesit legjitimohen (*locus standi*) për vënien në lëvizje të kësaj gjykate, sepse objekti I ligjit të kundërshtuar për papajtueshmëri me Kushtetutën është përcaktimi I përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit financiar për ish të dënuarit politikë, ndërkohë qëllimi i tyre është mbrojtja e të drejtave të ish të dënuarve politikë, të sanksionuara nga legjislacioni vendas si dhe nga aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këto kushte, ekziston edhe lidhja e domosdoshme ndërmjet qëllimit për të cilin janë krijuar të dy shoqatat dhe çështjes kushtetuese të ngritur prej tyre.

Përsa I përket pretendimit të subjektit të interesuar, Kuvendi I Shqipërisë, se kërkuesit nuk legjitimohen pasi nuk përfaqësojnë të gjithë kategoritë e të ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist dhe se kërkesa e tyre nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të ish të dënuarve politikë, Gjykata e vlerëson të pabazuar. Për efekt të legjitimitit nuk është e nevojshme që

kërkuesit të provojnë se përfaqësojnë të gjithë ish të dënuarit politikë nga regjimi komunist, apo kërkesa e tyre të mbështetet edhe nga shoqatat e tjera, pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, I cili përcakton rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimimin.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se, mbështetur në nenin 134, pika 1 shkronja “f” dhe 134, pika 2 të Kushtetutës, Shoqata e ish të Burgosurve Politikë dhe Shoqata Kombëtare e Dëbim Internimeve Politike legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 9831, 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”

Gjykata vlerëson, se për të gjitha pretendimet në lidhje me nenin 1, 8 dhe 12, për të cilat ligji I ri ka sjellë shtesa dhe ndryshime, çështja mbetet pa object, e për rrjedhojë, duhet të pushohet.

Perfundimi: Pushimin e gjykimit të çështjes lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 1, 8 dhe 12 të Ligjit nr.9831, 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”

Te reja: Gjykata vlerëson, se për të gjitha pretendimet në lidhje me nenin 1, 8 dhe 12, për të cilat ligji I ri ka sjellë shtesa dhe ndryshime, çështja mbetet pa object, e për rrjedhojë, duhet të pushohet.

Vendimi:	Nr. 11, datë 06.04.2010
Kerkues:	Union i Gjyqtareve te Shqiperise
Objekti:	Shfuqizimi si antikushtetues i pikës 1 dhe 2 të nenit 2, nenit 3, 4 dhe 6 të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publikë dhe Nëpunësit Civilë”, përsa përfshijnë në fushën e zbatimit të tyre funksionarët publikë vijues: gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit.

Legjitimimi: Çështjen e legjitimitetit të kërkuesit, (locus standi) Gjykata Kushtetuese (këtu e në vijim Gjykata) e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. subjektet iniciues që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, në cilësinë e “organizatave të tjera”, janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 10.10.2007). Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet racione personae në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “f” i Kushtetutës dhe neni 49, pika 2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Unioni është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2171, datë 04.02.2008. Në Statutin e Shoqatës, neni 1, parashikohet: “Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare”. Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata vlerëson se Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

Kërkuesi legjitimohet racione temporis, pasi kërkesa është regjistruar brenda afatit 3 vjeçar të përcaktuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet racione materiae edhe përsa i përket pretendimeve të tij në mbrojtje të pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese.

Perfundimi: Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1 dhe 2 të nenit 2, nenin 3, nenin 4 dhe nenin 6 të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publikë dhe Nëpunësit Civilë”, për sa përfshijnë në fushën e zbatimit të tyre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetarin e Gjykatës së Apelit.

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.11.2009, “Për caktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore,” për sa përfshin në fushën e zbatimit të tij Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Vendimi: Nr. 28, datë 27.05.2010

Kerkesues: Shoqata e distributoreve farmaceutike të Shqipërisë

Objekti: (a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, në pjesën integrale lista e çmimeve të barnave që rimbursohen në rubrikën “referenca”.

(b) Pezullimi i zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009, në pjesën e aktit objekt shfuqizimi në këtë kërkesë (rubrika “çmimi referencë” i listës së barnave të rimbursuara).

Legjitimimi: Lidhur me legjitimitetin e Shoqatës së Distributorëve Farmaceutikë të Shqipërisë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas objektit të kërkesës

Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007). Ato kanë detyrimin të provojnë lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurd, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Gjykata vlerëson se VKM objekt shqyrtimi ka një lidhje të drejtpërdrejtë me veprimtarinë ekonomike të anëtarëve të shoqatës kërkuese, prandaj kjo shoqatë mbart interesin për të kundërshtuar këtë VKM (në pjesën e përshkruar në objektin e kërkesës), e për rrjedhojë legjitimohet në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 11/3 dhe 17/1 të Kushtetutës.

Perfundimi: - Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, në pjesën integrale lista e çmimeve të barnave që rimbursohen, në rubrikën “referenca”.

Ndikimi: Gjykata rithekson se liria e veprimtarisë ekonomike, garantuar nga neni 11 i Kushtetutës nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj.

Vendimi: Nr. 31, datë 18.06.2010

Kerkesues: 1 Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë

2 Sindikata e Pavarur e Minatoreve të Shqipërisë

- 3 Konfederata e Sindikatave te Shqiperise
- 4 Sindikata e Pavarur e Transportit te Shqiperise
- 5 Sindikata Rajonale Elbasan

Objekti: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””.

Legjitimiteti: Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese rithekson se Kushtetuta ka parashikuar një numër të zgjeruar subjektsh që mund t’a vënë atë në lëvizje për të inicuar një gjykim kushtetues. Në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të saj parashikohen si subjekte të tilla edhe organizatat. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ligjvënësi kushtetues ka pasur për qëllim të përfshijë në rrethin e “organizatave të tjera” të gjitha ato shoqata, fondacione, sindikata ose organizime të tjera me karakter të ndryshëm, duke përfshirë edhe ato me karakter politik, që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore. Pra, ligjvënësi kushtetues, edhe brenda kësaj kategorie, ka patur për qëllim ta zgjerojë atë, duke mos e kufizuar vetëm në shoqata, por duke i përcaktuar ato me termin e përgjithshëm “organizata” (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008).

Në lidhje me këto subjekte, ligjvënësi kushtetues ka parashikuar një të drejtë të kufizuar për të inicuar gjykimin kushtetues, duke kërkuar që të provojnë lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 28.04.2009; nr.16, datë 25.07.2008; nr.9, datë 19.03.2008; nr.41, datë 16.11.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr.9, datë 26.02.2007). Për pasojë, vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë patur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut.

Gjykata vëren se, në rastin në shqyrtim, kërkuesit janë persona juridikë, të regjistruar me vendim të gjykatës dhe, sipas statuteve përkatëse, janë organizata vullnetare që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përfaqësimin e punonjësve shqiptarë, sipas kategorive përkatëse të punëmarrësve që përfaqësojnë, në mbrojtje të interesave të tyre social-ekonomike. Sipas statutit, burimet financiare të tyre realizohen nëpërmjet kuotës sindikaliste, si dhe nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të fituara.

Megjithëse sindikatat kërkuese i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e një të drejte subjektive, siç është e drejta e pronës private, Gjykata vlerëson se qëllimi i sindikatave është që t’i shërbejnë veprimtarisë sindikaliste dhe në funksion të këtij qëllimi është edhe përdorimi i pasurive nga ana e tyre. Në këto kushte Gjykata vlerëson se sindikatat legjitimohen të iniciojnë këtë gjykim kushtetues.

Perfundimi: Pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën ligjin nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””.

Vendimi: Nr. 33, datë 24.06.2010

Kerkues : Shoqata Kombetare e Ushtarakeve ne Rezerve
Avokati i Popullit
Sindikata e Punonjesve te Policise se Shtetit
Shoqata "Organizata e Punonjesve te Policise se Shtetit"

Objekti: 1. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

Legjitimimi: 1.2 Për legjitimitimin e kërkuësve të tjerë.

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimitimin e organizatave si subjekte që mund ta venë atë në lëvizje (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.03.2008; nr.41, datë 16.11.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr. 9, datë 26.02.2007*). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë, shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë", Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe shoqata "Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në Lirim" janë subjekte juridike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht me vendimet nr.2250, datë 25.03.1996; nr.2644, datë 30.09.2009, nr.3716, datë 17.05.2007 dhe nr.1942, datë 22.04.2007.

Gjykata vëren se sipas statutit të secilit prej kërkuësve të sipërcituar, në objektin e veprimtarisë përfshihet mbrojtja e interesave social-ekonomike të anëtarëve të tyre. Kërkuësit pretendojnë se ligji objekt i këtij gjykimi pranë Gjykatës dëmton interesat ekonomikë të anëtarëve të tyre nëpërmjet pakësimit të përfitimeve suplementare dhe cenimit të të drejtave të fituara. Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi parashikon një rregullim të ri të përfitimeve suplementare që gëzohen ose do të gëzohen nga anëtarët e kërkuësve, duke karakterizuar kështu lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Por Gjykata vëren se kjo lidhje e drejtpërdrejtë nuk ekziston në rastin e pretendimit të ngritur nga kërkuësi Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit përse i përket cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi. Gjykata vlerëson se neni 27 nuk përmban dispozita që rregullojnë përfitimet e punonjësve të Policisë së Shtetit, të drejtat e të cilëve mbrohen nga kërkuësi, por vetëm të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

Sa më sipër Gjykata vlerëson se, me përjashtim të pretendimit të Avokatit të Popullit dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi, kërkuësit dhe subjekti i interesuar shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë" legjitimohen përpara kësaj gjykate për iniciimin e këtij gjykimi kushtetues.

Perfundimi: - Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të nenit 14, si dhe të nenit 27 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

**AVOKATI I POPULLIT SI INSTRUMENT EFEKTIV DHE MBËSHTETËS
NË ROLIN E SHOQËRISË CIVILE NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
NJERIUT NDAJ CENIMEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

1. Hyrje

Që OJF-të luajnë sa më mirë rolin dhe të përmbushin misionin e tyre, nevojitet të kenë një informacion sa më adekuat lidhur e institucionet të cilave mund ti drejtohen e ti mbështesin në zgjidhjen e një problemi. Në skemën e institucioneve në mbrojtje të të drejtave të njeriut, një vend të vecantë ka Avokati i Popullit. Interaktiviteti ndërmjet OJF dhe këtij institucioni është shumë i rëndësishëm me qëllim që secili të realizojë me sukses dhe në mënyrë adekuate misionin e vet. Qartësia e detyrave dhe përgjegjësi të një institucioni bën që kërkesat dhe pretendimet të drejtohen aty ku duhet dhe sigurojnë efektivitetin e cdo shërbimi. E kundra është vetëm sorollatje, stres e humbje kohe si edhe cenim i së drejtës.

Çfarë kompetencash ligjore ka Avokati i Popullit? A kanë të drejtë OJF-të ti drejtohen Avokatit të Popullit, në cilat raste dhe në ç'mënyrë? Çfarë duhet të presim nga reagimi i këtij institucioni? Si mund ti shfrytëzojnë OJF-të të gjitha mekanizmat dhe instrumentet në dispozicion për mbrojtjen e një të drejte dhe të një interesi të ligjshëm? - Pyetje të tilla dhe shumë të tjera kërkojnë përgjigje, për të bërë të mundur që shoqëria civile me instrumentet e saj dhe institucionet e ndërtuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana tjetër, të luajnë rolin e tyre.

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, aksesit në të drejtë dhe në sistemin e drejtësisë si edhe në institucionet e tjera - janë elementët bazë dhe tregues cilësorë të shtetit të së drejtës. Ndërkohë që kuadri ligjor është gjithnjë e më pranë standardeve ndërkombëtare dhe ka tendencën që të harmonizohet në vazhdimësi me to, nuk mund të themi që kemi arritur gjithçka dëshirojmë. Përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe përdorimi i institucioneve nga shtetasit dhe operatorë të tjerë, ka ende vend për përmirësim dhe ende ka vështirësi.

Sa aktive kanë qënë OJF në raportet me Avokatin e Popullit? Ku qëndrojnë vështirësitë e OJF-ve?

Përgjigjja do të ishte: në shumë aspekte! Vështirësitë janë të lidhura me pasigurinë që vjen nga mos njohja e ligjit. Gjithashtu duhet pranuar se mekanizmat institucionale jo gjithnjë janë treguar konsekuente dhe me nivel të lartë ose optimal profesional ndaj kërkesve, trajtimit të kërkesës së tyre, pretendimit, ankesës, njoftimit të bërë, etj. Kështu në vend të nxitjes në mbrojtje të së drejtës, këto qëndrime të institucioneve, kanë ndikuar në dekurajimin dhe janë bërë frenues ndaj aksesit në shërbimin që ofrojnë. Herë të tjera ka një ndrojtje dhe tërheqje për shkak të mos njohjes prej të interesuarve të mundësive

ose pasigurisë e padijenisë lidhur me mënyrën dhe mjetin e kërkimit të një të drejtë të cenuar apo që pretendohet si e tillë. Herë të tjera ligji ka qenë një “zbukurim” i pa shoqëruar me strukturat adekuate qoftë në kuptimin e burimeve njerëzore ashtu edhe të institucioneve referuese.

Në përpjekjet për respektimin e të drejtave të njeriut, një vend të veçantë zë shoqëria civile dhe OJF. Në skemën e institucioneve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut një rol të veçantë ka Avokati i Popullit. Është koha që këtë institucion ta njohim më mirë për ta “përdorur” në mënyrë të dobishme në mënyrë që secili me vete (OJF dhe Avokati i Popullit) e të gjithë sëbashku të realizojmë qëllimet e misioneve tona.

“Konsolidimi i procesit demokratik të qeverisjes, arritja e mirëqeverisjes dhe respektimi i të drejtave të njeriut e kërkojnë gjithmonë e më tepër rolin e Avokatit të Popullit. Natyrisht, ushtrimi në mënyrë të efektshme i përgjegjësive në mbrojtje të të drejtave të njeriut lidhet domosdoshmërisht me një qeverisje të kontrollueshme, një parlament pluralist dhe një gjyqësor të pavarur. Por, shoqëritë moderne po provojnë çdo ditë e më shumë se ekzistenca e këtyre institucioneve sipas ndarjes klasike të tre pushteteve është e paplotë pa veprimtarinë e institucioneve të tjera të pavarura, të cilat së bashku bëjnë të mirëfunksionojë sistemi i kontrollit dhe balancës së pushteteve dhe në të cilin luajnë rol të rëndësishëm një shoqëri civile e fortë dhe një shtyp i lirë dhe i përgjegjshëm. Pikërisht, në këtë sistem, pranë sferës së qeverisjes dhe shoqërisë civile është vendosur Avokati i Popullit, në garanci të demokracisë dhe mirëqeverisjes”²³.

Pyetjet e mundshme

- 1.Cili është misioni dhe roli i Avokatit të Popullit?
- 2.Cilat janë shkeljet për të cilat mund ti drejtohem Avokatit të Popullit?
- 3.Kush mund ti drejtohet Avokatit të Popullit?
- 4.Më ç'mënyrë mund ti drejtohem Avokatit të Popullit?

Për këtë arsye, në vijimësi do të trajtojmë kuadrin ligjor që ka rëndësi për të dhënë përgjigje pyetjeve të mundshme lidhur me mundësitë e “përdorimit” të Avokatit të Popullit, nga OJF- të. Kështu, pyetjet rreth të cilave do të fokusohemi kanë të bëjnë me:

Për të realizuar këtë, do të përqendrohemi në disa ligje që përbëjnë bazën e përgjigjeve por edhe në veprimtarinë e deritanishme të OJF dhe të Avokati i Popullit si bashkëpunëtorë seriozë në përpjekjet për mbrojtjen e respektimin e të drejtave të njeriut. Kështu, gjithë analiza

do të fokusohet në standardet që burojnë nga:

- Kushtetuta e RSh;
- Ligji “për Avokatin e Popullit” (ndryshuar);
- Ligji “Për OJF” (ndryshuar);

²³ Fjala e Presidentit të Republikës ShtZ. Bamir Topi me rastin e 10 vjetorit të institucionit të Avokatit të Popullit. Burimi <http://www.avokatipopullit.gov.al/Aktivitate/Akt2%2010122009.htm> (aksesuar në Nëntor 2010).

- ❑ Raporte të Avokati i Popullit dhe përvoja të OJF lidhur me këtë bashkëpunim.

2. Misioni dhe detyrat e Avokati i Popullit me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Qasja me rolin e OJF.

Pavarësisht nga diversiteti në një sërë drejtimesh, një analizë gjithpërfshirëse na con në konkluzionin se nuk janë ta pakta kontaktet e misionit të Avokatit të Popullit me ato të OJF-ve.

Sipas Kushtetutës së RSH [nenet 60-63; 134] dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Në këtë mënyrë, edhe përmes këtij institucioni, synohet të monitorohet e të mbahet “nën kontroll” sikurse edhe ti jepet performancë e re vizionit dhe misionit të administratës publike e cila ka tendencën që herë pas herë “të cedojë” ose të keqpërdorë diskrecionin e vet duke cenuar kështu të drejtat dhe liritë e garantuara me ligj.

Nga ana tjetër, OJF ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut²⁴. Sipas ligjit për OJF, me "veprimtari në të mirë dhe interes të publikut" kuptohet çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individi dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut. Ndër parimet mbi bazën e të cilave mbështetet veprimtaria e organizatave jofitimprurëse është parimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

Pra, vëmë re se qëllimi dhe parimet thelbësore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, OJF-ve dhe administratës publike janë të njëjta. Secili, në varësi të misionit dhe veçorive ka prioritet të drejtat e njeriut dhe realizimin e një veprimtarie në të mirë dhe interes publik.

Etiketimi e vlerësimi jo gjithnjë pozitiv i “sjelljes” së administratës publike nuk është një paragjykim, por konkluzion i një sërë analizash dhe monitorimesh të veprimtarisë së saj. Kështu, psh, Indeksi i reformës gjyqësore²⁵, ndonëse analizon veprimtarinë e sistemit të drejtësisë, nuk e sheh këtë të shkëputur nga hallka të tjera. Në këtë dokument nënvizohet se në çështje që kanë të bëjnë me doganat, pronësinë, prokurimet publike, etj pjesëmarrja e “qeverisë” përshkruhet si e ngadaltë dhe penguese. Për më tepër këtu theksohet se

²⁴ Shih neni 1, 2&6, 5, etj të Ligjit nr.8788/ 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprirëse” (ndryshuar)

²⁵ Indeksi i Reformës Gjyqësore. Shqipëri Vol IV. Fq 24

ekzekutimi i vendimeve është një problem endemik i sistemit në tërësi por kryesisht i vendimeve me palë shtetin. Ka një sërë vendimesh të GJEDNJ që i referohen pikërisht penalizimeve bërë shtetit shqiptar që vijnë si rezultat i mungesës së mjeteve efektive (neni 13 KEDNJ) dhe mos veprimit të autoriteteve administrative dhe të përmbartimit²⁶. Në këto kushte, OJF-të kanë një mision të rëndësishëm. Të mbrojnë taksapaguesit shqiptarë nga veprimet burokratike të administratës publike të cilat çojnë në mohimin e të drejtës dhe mandej në penalitete që ndikojnë mbi të gjithë!

Duke qenë se Avokati i Popullit, veç të tjerave të përcaktuar në kushtetutë e ligj, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ka mundësi që në mënyrë të pavarur dhe të paanshme të efektojë në mbrojtjen e interesave të qytetarëve kur këto interesa referohen si të cenuara nga OJF-të. Në këtë proces të veprimtarisë së tij Avokati i Popullit verifikon problemin e adresuar duke u ballafaquar me të gjithë dokumentacionin dhe informacionet të cilat i vihen në dispozicion nga organi administrativ. Kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa.

**Tipar i Avokatit të Popullit është:
Forca e rekomandimeve të tij!**


Gjithashtu, sipas nenit 134/1&dh dhe 134/2 të Kushtetutës, për çështje të interesit të vet, Avokati i Popullit mund ti drejtohet edhe Gjykatës Kushtetuese. Këto nuk kanë qenë raste të rralla. Pra është në diskrecion të plotë të Avokatit i Popullit që të zgjedhë mjetin më efektiv në mbrojtje të drejtave të individit dhe ky mjet në disa raste shumë të rëndësishme ka qenë kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese²⁷.

Raportet e paraqitura përpara Kuvendit bëjnë që shqetësimet dhe problemet adresuara Avokati i Popullit edhe prej OJF-ve të përçohen në organin legjislativ i cili mund të parashikojë eventualisht, rast pas rasti, nevojën e ndërhyrjeve ligjore. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon si të rëndësishme dhe jep llogari vetëm para Kuvendit. Në këtë mënyrë veç instrumenteve të tjera, shoqëria civile mund të “përdorë” efektivisht Avokati i Popullit për të përçuar mesazhe të rëndësishme lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut ndaj të cilave duhet ndërhyrje ligjore, administrative, etj.

²⁶ Shih rastin Driza v Shqipërisë (33771/02); Qufaj Co Shpk v. Shqipërisë (54268/00 datë 18.11.2004); Marini v. Shqipërisë (3738/02, datë 8.12.2007).

²⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me Vendimin e saj nr.49 dt.31.07.2000 ka vendosur që Avokati i popullit, në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rastet e parashikuara nga nenet 49, 52 dhe 71 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i popullit, si dhe kur janë cenuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të tij.

Grafiku paraqet në mënyrë kronologjike, sipas viteve, ankesat apo kërkesat paraqitur nga OJF në institucionin e Avokatit të Popullit nga viti 2005. e dhëna për vitin 2010 nuk është e plotë, por i përket vetëm tremujorit të parë të këtij viti.



Objekti i ankesës dhe kërkesës natyrisht lidhet me fushën e veprimtarisë së OJF duke e përputhur këtë kërkesë apo ankesë detyrueshmërisht me juridiksionin e Avokatit të Popullit. Pra ankesat dhe kërkesat kane pasur te bëjnë qofte për shkelje te drejtave te anëtarëve te shoqatës nga organet e administratës publike apo për përmirësim legjislacioni, i cili lidhet me fushën e veprimtarisë së tyre.

Interaktiviteti ndërmjet Avokati i Popullit dhe OJF-ve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, është nënvizuar edhe në ligjin për Avokatin e Popullit, në nenin 31/3 të të cilit flitet për strukturën e këtij institucioni në të cilën gjendet seksioni lidhur me bashkëpunimin me OJF. Gjithashtu në nenin 30 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nënvizohet rëndësia e bashkëpunimit dhe format e bashkëpunimit të OJF me AP, përmes:

- Marrjes periodikisht të mendimit të tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut sipas këndvështrimit të shoqërisë civile²⁸;*
- Organizimi në bashkëpunim të paktën një herë në vit të veprimtarive kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.*

Neni 31: Struktura

Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në 3 seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët.

Keto seksione janë:

1. Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të treteve, që veprojnë për llogari të tyre.
2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor.
3. Seksioni i përgjithshëm për trajtimin e çështjeve jashtë fushave të mesiperme, për bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe për studimet e veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Pra, jo vetëm OJF-të kanë nevojë për

²⁸ përfaqësues të OJF-ve që punojnë me/ për: dei Bambini, Qendra Bethany, CRCA, "”, Parlamenti Rinor, QTMPKF, Save the

mbështetjen dhe bashkëpunimin me Avokatin e Popullit, por edhe anasjelltas duke i krijuar këtij mundësinë që të ketë një lidhje dhe angazhim konkret në mbrojtjen e interesave të OJF.

3. Dy fjalë për kuptimin dhe veprimtarinë e administratës publike

Administrata publike, Avokati i Popullit dhe OJF në veprimtarinë e tyre në mbrojtje të lirive të dhe të drejtave themelore të njeriut, mbështeten në një bazë ligjore të përgjithshme dhe në të njëjtat parime. Përpos, këto kanë edhe legjislacionin e tyre specifik i cili është mbështetur në këto parime të përgjithshme.

Por çfarë përfaqëson administrata publike? Është një nocion shumë i gjerë dhe shumë i madh administrata publike. Për këtë është e rëndësishme të dimë se çfarë përfshihet në veprimtarinë administrative. Në ndihmë na vjen kryesisht Ligji “Për procedurat administrative”²⁹ por edhe projekt ligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe gjykatat administrative”.

Sipas nenit 2 të ligjit “Për procedurat administrative”:

1. Veprimtaria e organeve administrative është tërësia e *akteve* dhe *veprimeve* nëpërmjet të cilave formohet dhe manifestohet vullneti i administratës publike, si dhe ekzekutimi i këtij vullneti.

2. Format e veprimtarisë administrative të rregulluara me këtë ligj janë:

- aktet administrative individuale dhe kolektive;
- kontratat administrative/publike; dhe
- aktet reale.

Janë organe administrative ose organe të administratës publike³⁰:

- organet e pushtetit qendror të cilat kryejnë funksione administrative;
- organet e enteve publike në masën që ato kryejnë funksione administrative;
- organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative;
- organet e Forcave të Armatosura, si dhe çdo strukturë tjetër, punonjësit e se cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative.

Çdo akt dhe veprim administrativ, i çfarëdo niveli rregullues, del *si rregull* në bazë dhe për zbatim të ligjit. Në këto kushte është shumë e rëndësishme që të njihen parimet dhe procedurat që duhet të udhëheqin veprimtarinë e autoriteteve administrative në nxjerrjen e akteve administrative dhe në realizimin e veprimtarisë së tyre. Shtylla të tilla si Kodi i Procedurave Administrative (KPA), KPrC³¹, ligji nr. 8480/27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", ligji nr. 8510/15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës

²⁹ Ligji nr.8485/12.5.1999 “Për procedurat administrative”

³⁰ Projekt ligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe gjykatat administrative” përdor këtë përkufizim lidhur me “Organin publik”: çdo organ i pushtetit qendror apo i njësisë të qeverisjes vendore. Barazohet me organin publik çdo ent publik i krijuar me ligj, çdo person, juridik apo fizik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor, kontratë apo çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

³¹ **Kujdes!** Në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohen nenet 324 deri 333 dhe shkronja “a”, e nenit 320. Pra, gjithë kreu i gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative.

shtetërore”; Ligji “Për kundërvajtjet administrative”, Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” [2000, ndryshuar] etj, ligjet specifike janë të domosdoshme të shfletohen dhe të njihen në rastin kur administrata kryen një veprim i cili cenon të drejtat e shtetasve.

Kujt i shërben administrata publike? OJF-të, por edhe AP, e kanë për detyrë të njohin veprimtarinë dhe politikat e administratës publike. Pse është krijuar administrata publike? Çfarë detyrash dhe pushteti ka administrata publike dhe si i realizon këto?

Administrata publike konsiston në një pafundësi detyrash dhe pushtetesh. Këto burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore. Detyrat dhe pushtetet e organeve administrative nuk janë një çështje statike. Ndryshimet sociale, politike, ekonomike, etj në vend, imponojnë edhe ndryshime në kornizën ligjore dhe këto efektojnë edhe administratën publike si të tillë. Disa here detyrat dhe pushtetet shtohen dhe anasjelltas. Në disa drejtime edhe mund të *quasi* reduktohen. Ndërkohë është evidente një tendencë që këto të mos pakësohen në thelbin e tyre por tu kalojnë “si shërbime” privatëve. Edhe në këtë rast, përsëri raporti ynë qëndron si të ishte me administratën publike, sepse është përgjegjësia indirekte e saj në shpërndarjen e detyrave njërit apo tjetrit subjekt.

Konteksti ligjor që efektikon detyrueshmërisht aktivitetin e OJF-ve dhe të Avokatit të popullit imponon njohjen e kujdesshme të gjerë dhe të thellë të kësaj veprimtarie.

4. Subjektet që i drejtohen Avokati i Popullit dhe mënyra/mjetet

Na rezulton se nuk gjendet në Kushtetutë, një listë subjektësh që kanë të drejtë ti drejtohen AP. Interpretimet jo vetëm të ngushta por edhe jo të sakta, herë pas here, kanë komentuar këtë duke marrë si pikënisje termin “individ” që përmendet në Kushtetutë në nenin 60 dhe duke e njohur këtë të drejtë vetëm për “individët”. Ndonëse interpretimi i Kushtetutës është në kompetencë të GJK [neni 124 i Kushtetutës], na lejohet të pranojmë se edhe leximi i thjeshtë i nenit 60 nuk ka të bëjë me subjektet që kanë të drejtë ti drejtohen AP, por me (a) subjektet “pasivë”, pra ata që cenohen dhe që mbrohen nga AP, dhe këta janë individët dhe (b) subjektet “aktivë” të cilët me veprime apo mosveprime cenojnë të drejtat, liritë dhe interesat e të parëve. Ndërkohë duke e parë Kushtetutën në tërësi si një dokument, e për ti dhënë edhe një kuptim më të plotë subjekteve “pasivë”, konstatojmë se Ajo vet në nenin 16&2 ka garantuar se “Te drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetute vlejnë edhe për *personat juridike*, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave”.

Kuptohet që Kushtetuta është një dokument sintetik dhe telegrafik tepër cilësor dhe si e tillë nuk mund të ezaurojë të gjitha rregullimet. Për këtë qëllim i referohemi detajeve që gjenden në Ligjin Nr.8454/ 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” ndryshuar³². Sipas nenit 12 të drejtën për tu ankuar tek Avokati i Popullit e ka:

³² Ligji nr.8600/10.4.2000, Për një shtesë në Ligjin nr. 8454/4.2.1999 "Për AP"; Ligji nr.9398/12.5.2005 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8454/4.2.1999 "Për AP", ndryshuar me Ligjin nr. 8600/10.4.2000.

- Çdo individ,
- grup individësh ose
- organizata joqeveritare.

Për çfarë mundet që OJF ti drejtohen AP? OJF-të mund ti drejtohen Avokati i Popullit në rastet kur këto pretendojnë se u janë shkelur te drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre (interesi që ato mbrojnë për shkak të misionit të tyre) te ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administratës publike. Për këtë është shumë e rëndësishme që OJF të ketë kuptuar mirë që shqetësimi i paraqitur prej saj është i lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit të AP. Vënia në lëvizje e Avokatit të Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave të njeriut nga veprimtaria e administratës publike. Pra e rëndësishme është të theksohet se OJF-të legjitimohet për t’iu drejtuar Avokati i Popullit kur individë, grupe individësh përfshirë edhe personat juridike, pretendojnë se janë cenuar në të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të tyre nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike.

Në ç’mënyrë OJF vënë në dijeni/lëvizje Avoaktin e Popullit? OJF kanë të drejtë të ankohen ose te njoftojnë Avokatin e Popullit dhe te kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien ne vend te se drejtës ose lirisë se shkelur.

Avokati i Popullit duhet te ruaje fshehtësinë nëse e sheh te arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi qe bën ankesën, kërkesën, apo njoftimin.

Mënyra e vënies në lëvizje të AP:

- përmes një ankese;
- përmes një kërkesë;
- përmes një njoftimi.

Ligji për Avokatin e Popullit nuk kërkon një formë të veçantë apo të paracaktuar lidhur me ankimin apo njoftimet që i bëhen këtij institucioni. E vetmja kërkesë është që:

- Qartësia: pra , të jetë i qartë objekti i ankimit ose i kërkesës a njoftimit. Pra, OJF duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga AP.
- Subjekti: Të jetë i qartë subjekti që e paraqet atë. Avokati i Popullit nuk pranon ankesa ose kërkesa anonime.

5. Parimet e veprimtarisë dhe çështjet e kompetencës së Avokatit të Popullit

Sipas ligjit nr.8454/4.2.1999 ndryshuar “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit mbron te drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm te individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administratës publike, si dhe te te tretëve qe

veprojnë për llogari të saj [neni 2]. Në këtë veprimtari Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e:

- pavarësisë nga politika dhe tre pushtetet e tjera.
- Paanësisë dhe integritetit,
- konfidencialitetit dhe besueshmëria
- profesionalizmit dhe qartësia në qëllime dhe veprimtari
- transparenca

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejte të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të se drejtës ose lirisë se shkelur.

Avokati i Popullit duhet të ruaje fshehtësinë nëse e sheh të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën, apo njoftimin. Të gjitha shërbimet e Avokati i Popullit lidhur me ankesa, njoftimet kërkesat janë pa pagesë.

Në rastin e paraqitjes së një ankese, njoftimi apo kërkesë nga OJF, kur Avokati i Popullit vëren ose dyshon se kemi të bëjmë me një shkelje të së drejtës, fillon procedurën e shqyrtimit të ankesës.

6. Gamë e gjerë bashkëpunimi me Avokatin e Popullit. Për çfarë mund të drejtohen OJF-të Avokatit të Popullit?

- Avokati i Popullit dhe njoftimet, kërkesat apo ankesat lidhur me legjislacionin**

Në veprimtarinë e tyre OJF-të konstatojnë aspekte të ndryshme të problemeve në legjislacion. Të tilla mund të jenë zbatimi jo korrekt i ligjit nga institucionet; pamundësia e zbatimit të një dispozite për shkak të mungesës së akteve nënligjore, ligji vjen në kundërshtim me interesin publik dhe me kushtetutën; mungesë koherence ndërmjet ligjeve të ndryshme; paplotësi në një ligj; mungesë harmonizimi me standardet ndërkombëtare, etj.

Në këtë mënyrë OJF përmes njoftimeve apo kërkesë/ankesave paraqitur pranë institucionit të Avokatit të Popullit bëjnë që të zbatohet efektivisht neni 24 i ligjit “Për Avokatin e Popullit” (shih gjithashtu kreun IV të ligjit). Në morinë e ligjeve dhe të ndryshimeve të tyre të shpeshta, OJF, kanë privilegjin që duke u specializuar në një fushë të caktuar të monitorojnë edhe efektivitetin, dobishmërinë dhe standardet e legjislacionit. Nga ana tjetër, grupet me të cilat bashkëveprojnë OJF, kanë mundësinë e transmetimit të drejtëpërdrejtë të cdo shqetësimi dhe boshllëku ligjor për shkak të konfidencës së krijuar.

□ Avokati i Popullit mund të pranojë ankesa, kërkesa e njoftime ndaj çështjeve të lidhura me pushtetin gjyqësor dhe vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Sipas nenit 25 (paragrafi i fundit) të Ligjit nr.9398/12.05.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8454/4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”: “*Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve*”.

Kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit, në këtë drejtim, janë tregues dhe kërkesa e një shoqërie dhe qeverisje demokratike të zhvilluar, për të rritur kontrollin e ndërsjellët ndërmjet veprimtarisë së institucioneve që garantojnë të drejtat e njeriut.

Kështu, AP mirëpret ankesa, kërkesa apo njoftime lidhur me administratën gjyqësore. Administrata e gjykatave si pjesë e sistemit të drejtësisë luan një rol të rëndësishëm në efektivitetin e aksesit në drejtësi dhe në gjykatë.

Ndryshimet e vitit 2005 që iu bënë ligjit për AP, përfshinë aksesin e këtij institucioni ndaj vendimeve të formës së prerë. Ky rol i Avokatit të Popullit ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, thjesht rrit garancitë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, transparencën e gjyqësorit si dhe pjesëmarrjen e publikut në dhënien e drejtësisë nga ana e gjykatës dhe si i tillë, nuk cenon aspak pavarësinë e gjyqësorit, përkundrazi ndihmon punën e tij. Është fjala për një kompetencë për të ushtruar të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishikim të këtyre vendimeve në Gjykatën e Lartë, si një nga mjetet e jashtëzakonshme që ligji u njeh subjekteve perkatese në këto raste (shih plotësimet e neneve 438, 449 dhe 451 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile). Gjithmone behet fjala që Avokati i Popullit do të bëjë kërkesa për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në rastet kur sita e kontrollit gjyqësor ka lejuar të rrjedhin edhe gabime gjyqësore, për të cilat nuk ka mjet tjetër korrigjimi. Është fjala që Avokati i Popullit të futet në subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë; kërkesa për njesim ose ndryshim të praktikës gjyqësore nga ana e gjykatave, si dhe rishikimi i qendrimit të Kolegjeve të Bashkuara në Gjykatën e Lartë lidhur me vendimet unifikuese. Gjithmone duke e lënë në çmimin e gjykatës mënyrën se si do ta bëjë këtë, përfshirë edhe refuzimin, pra kjo nënkupton se nuk ka prekje të pavarësisë së gjyqësorit.

Nga ana tjetër, ankesa, njoftime kërkesa mund të kenë të bëjnë edhe me procedurat gjyqësore. Ka disa aspekte të këtyre procedurave që janë strikte dhe të rregulluara ligjërisht, ka të tjera ku ka vend për më shumë diskrecion. Diskrecioni mund të shkojë edhe deri në cenim të standardeve, e këtu është rasti për të reaguar.

□ Çështje lidhur me të drejtat e fëmijëve

Ka shumë OJF që ia kanë dedikuar veprimtarinë e tyre mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Si të tilla, këto kanë mundësi që të njohin problematikën dhe të sugjerojnë alternativa zgjidhjeje.

Problemet që hasin fëmijët sot burojnë nga shumë faktorë si gjendja dhe niveli i ulët ekonomik e social i vendit, tronditja e bazamentit tradicional të familjes shqiptare, por mbi të gjitha moszbatimi efikas i ligjit dhe mos bashkëpunimi i duhur nga agjencitë e caktuara si policia, prokuroria, gjykata, shërbimet inteligjente dhe struktura të tjera të shtetit si pushteti vendor, shkollat, institucionet e ndihmës dhe përkrahjes sociale etj. Jo në pak raste elemente të korruptuar të këtyre strukturave të shtetit kanë bërë pjesë apo kanë favorizuar këtë situatë, por shumë prej tyre nuk kanë marrë dënimin e merituar. Në një rast të tillë pritet që OJF-të të jenë zëri i fëmijëve.

□ Aksesit në institucionet e privimit të lirisë (paraburgim, burgje)

Ka shumë rrezik që aty ku liria e personit është e kufizuar edhe të drejtat e njeriut të ndihen me shume të kërcënuara. Avokatit i Popullit Shqiptar gëzon para se gjithash avantazhin sepse ka një juridiksion të plotë për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe ka kompetenca të plota në këtë fushë. Brenda termit administrate publike janë të përfshira edhe institucionet shtetërore që mbulojnë sistemin penitenciar (burgjet dhe paraburgimet), organet e Policisë së Shtetit dhe ambientet ku mbahen persona të arrestuar, ndaluar apo shoqëruar, si dhe dhomat e izolimit disiplinor në Repartet e Ushtrisë Shqiptare.

Sipas nenit 19/1: “Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohe, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vene në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

□ Probleme të ndryshme që cenojnë apo efektojnë në mirëqeverisje

Institucioni i Avokatit të Popullit ka misionin e madh dhe shumë të nevojshëm: të ndihmojë drejtpërsëdrejti në forcimin e demokracisë dhe mirëqeverisjes dhe të sjellë më shumë transparencë dhe përgjegjësi për administratën publike. Veprimtaria e Avokatit të Popullit është e larmishme sikurse veprimtaria e administratës publike. Këtu mund të përfshihen:

- çështje të privatizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të ishpronarëve;
- respektimi i lirisë së informimit,
- çështje të rritjes së çmimeve si ato të energjisë elektrike dhe ujit,
- tarifave dhe taksave gjyqësore,
- tarifat e telefonisë fikse e celulare;
- mbrojtja e interesit të konsumatorëve,
- mbrojtja e të drejtave të pacientëve,

Dedikimi i Avokatit të Popullit ndaj edukimit dhe zhvillimit të një Qeverisjeje sa më të mirë

- mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara;
- probleme të të dënuarve dhe të persekutuarve politikë;
- çështje të mbrojtjes së mjedisit nga rreziqet e elektromagnetizmit, zhurmave e ndotjeve akustike;
- infrastruktura e ndriçimit të rrugëve,
- ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet shtetërore;
- mbrojtja e të drejtave të punonjësve (ku janë strukturat shtetërore në mbrojtje të tyre? Rasti i Gërdecit)
- te drejtat e ushtarakeve dhe të policisë;
- të drejtat e komunitetit rom, etj, etj.

VI. Përvoja pozitive bashkëpunimi OJF dhe AP

Për probleme të ndryshme OJF të ndryshme i janë drejtuar Avokati i Popullit. Si të tillë përmendim rastin e bashkëpunimit të Qendra për nisma Ligjore Qytetare Tiranë me AP, CRCA, Komitetit Shqiptar të Helsinkit etj.

Si mund të strukturohet një kërkesë/njoftim/ankesë

- Subjekti OJF që i drejtohet AP:*
- Misioni dhe veprimtaria kryesore e subjektit:* me qëllim legjitimitetin e kërkesës/njoftimit/ankesës
- Problemi që adresohet:* psh. paqartësi lidhur me përmbajtja e disa prej akteve ligjore e nënligjore që janë në fuqi dhe konkretisht të Ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Udhëzim nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Udhëzim nr.991/3, datë 2.3.2010 “Për një ndryshim në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.
- Argumentimi i problemeve në mënyrë më të gjerë me bazë ligjore e cenime të të drejtave:
- Argumentimi i rëndësisë së ndërhyrjes nga AP dhe nxitja e AP për ndërhyrje.

ROLI AKTIV I ORGANIZATAVE PËRMES NDËRHYRJES SË TYRE SI PALË TË TRETË NË PROCESET GJYQËSORE NË GJYKATAT KOMBËTARE DHE NË GJYKATËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.

1. Organizatat jofitimprurëse si palë ndërgjyqëse në gjykatat kombëtare

Organizatat Jofitimprurëse³³, si organizata të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut kanë një rol të rëndësishëm në lidhje me zhvillimin demokratik të vendit dhe respektimin e garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë një rëndësi të veçantë për pozicionimin e organizatave si subjekte të të drejtave dhe lirive themelore, me cilësinë e personave juridikë. Neni 162 i Kushtetutës sanksionon se: “Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”.

Organizatat jofitimprurëse e bazojnë veprimtarinë e tyre në parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuara në kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj³⁴.

Roli i Organizatave që punojnë në fushën e të drejtave të Njeriut, në mënyrë të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të grave nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi shfaqet edhe nëpërmjet ndërhyrjes së tyre në procese gjyqësore të zakonshme në gjykatat kombëtare ose nëpërmjet ndërhyrjes si palë e tretë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë themelore dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Në procesin gjyqësor të zakonshëm është e vështirë që një organizatë të ndërhyjë pa prokurë. Kjo mund të ndodhë vetëm në rastin kur një subjekt palë në process, i jep organizatës të drejtën që ta përfaqësojë atë.

Në fakt, shtrohet nevoja e parashikimeve ligjore më të plota që legjitimojnë një organizatë për ndërhyrje si palë e tretë në gjykim, ose për vënien në lëvizje të gjykimit.

Vetëm në këtë mënyrë ajo mund të shëndërrohet në një avokate të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të synojë mbrojtjen e të drejtave që kanë rëndësi jo vetëm për personin palë, por edhe për publikun në tërësi.

Parashikimet në ligj së paku në raste të veçanta, që mundësojnë ndërhyrjen e organizatave si palë e tretë në gjykim, ndihmojnë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të viktimave të trafikimit, viktimave të dhunës në familje, apo viktimave të diskriminimit për shkaqe të ndryshme.

³³ Artikulli fokusohet në rolin e Organizatave jofitimprurëse që punojnë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi.

³⁴ Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”, neni 5.

Kodi i Procedurës Civile në kreun e III, “Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin civil” parashikon ndërhyrjen dytësore. Referuar nenit 191 të Kodit të Procedurës Civile, “Ndërhyrja dytësore”, “Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes për të mbështetur njërën ose tjetrën palë, me të cilin bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë”.

Ndërhyrësi dytësor, ndërhyr në një çështje për të ndihmuar njërën palë. Për rrjedhojë gjithçka që ai realizon në proces bëhet për një të drejtë të tjetërkujt, por ai (personi i tretë) nuk është përfaqësues i palës, pikërisht pasi ajo është vetë e pranishme në çështje. ...Ndërhyrës dytësor mund të jetë vetëm personi i tretë që nuk është palë në proces, pra, nuk është as paditës as i paditur. Ligji nuk i vendos kusht tjetër kësaj ndërhyrje veçse të pasurit e interesit nga ana e ndërhyrësit dytësor. ...Ndërhyrësi dytësor nuk mbron në gjyq një të drejtë të tij, çka e dallon atë nga ndërhyrësi kryesor. Ai kufizohet, siç u tha, thjesht në mbështetjen e kërkesës së një pale, në varësi të interesit që ka që kjo palë të fitojë gjyqin.

I treti duhet të posedojë një lloj të veçantë legjitimitimi, i cili megjithëse nuk i lejon që të veprojë në mënyrë autonome mbi marrëdhënien e paraqitur në gjyq nga paditësi, është megjithatë i mjaftueshëm për të justifikuar ndërhyrjen dhe kërkesën e tij.³⁵

Pyetja që ngrihet këtu është a mund ofj-të ta përdorin këtë mundësi dhe çfarë interesi mund të ketë një organizatë për të mbështetur njërën apo tjetrën palë? Nga buron ky interes? Nëse do ta konceptonim interesin e organizatës gjerë, ky interes lidhet me çështje të interesave të komunitetit, në mënyrë të veçantë të target grupit të grave dhe vajzave të dhunuara, të drejtat njerëzore të të cilave janë në fokus të organizatës në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjithashtu, “Organizatave janë një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, jo vetëm për çështje individuale të organizatës, por edhe për një kontroll abstrakt të normës juridike, për çështje që lidhen me interesat e tyre. Në rastin kur interesi i tyre nuk konceptohet si një interes fare i ngushtë, i lidhur vetëm me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të organizatës, ato mund të shëndërrohen në avokate të vërteta të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tyre. Kështu, organizatave mund të përfaqësojnë në gjykatën Kushtetuese interesat e qytetarëve dhe të komunitetit.”³⁶

Praktika e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare e ka lejuar këtë, përmes legjitimitimit të organizatave kur ato e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, jo thjesht për interesat e tyre të ngushta, por edhe për interesat publike, madje edhe për interesat e të tretëve, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut dhe të vetë Kushtetutës³⁷.

³⁵Prof. asoc. Dr. Ardian Nuni & Asim Vokshi (Ma) “Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil”, botuar në revistën juridike shkencore “Jeta Juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, Viti i shtatë i botimit, nr.1, mars 2010, fq.5-23.

³⁶ Prof.dr. A.Anastasi, “Transparenca një rrugë drejt besimit të publikut”, “Roli i Organizatave për forcimin e rendit kushtetues në Shqipëri”, botim i QAGJZH, Tiranë 2008, fq.60-61.

³⁷ Prof.dr. A.Anastasi, “Transparenca një rrugë drejt besimit të publikut”, “Roli i Organizatave për forcimin e rendit kushtetues në Shqipëri”, botim i QAGJZH, Tiranë 2008, fq.61.

Gjykata e ka konsideruar legjitime kërkesën që i është drejtuar asaj nga disa organizata shqiptare me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2006, për shkak se këto vendime kanë kufizuar pa ligj të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë³⁸.

Janë dispozita të caktuara në ligje të veçanta si ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ligji nr.10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të cilat parashikojnë një rol aktiv të organizatave jofitimprurëse nëpërmjet përfaqësimit ligjor, vënies në lëvizje dhe mbështetjes së rasteve në gjykatë.

Neni 30 i Ligjit nr.9970, datë 24.07.2008, “Për Barazinë Gjinore në shoqëri”, “Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” parashikon se organizatat jofitimprurëse, të licënuara për ofrim shërbimi social mund të përfaqësojnë ose të mbështesin në procese ligjore, në emër të ankuesit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Kjo dispozitë ofron mundësinë e një roli shumë aktiv të organizatave jo vetëm nëpërmjet përfaqësimit por edhe mbështetjes në procese ligjore, për çështje që lidhen me garantimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Neni 34 i ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim” parashikon se: “Një organizatë me interes të ligjshëm ose komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi.”

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familiare” parashikon qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licënuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si subjekte që legjitimohen për paraqitjen e kërkesës për Urdhër Mbrojtje për të mitur dhe Urdhër të menjëhershëm mbrojtje për persona madhorë dhe të mitur³⁹.

Nuk rezulton një praktikë e konsoliduar në vendin tonë, ku Organizatat Jofitimprurëse që punojnë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi të luajnë këtë rol, të vënë në lëvizje ose të ndërhyjnë si palë të treta në gjykatat e brendshme.

2. Organizatat jofitimprurëse si palë ndërgjyqëse në gjykatat ndërkombëtare

Një rëndësi të veçantë marrin edhe garancitë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të cilat përfshijnë Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por jo vetëm.

³⁸ Prof.dr. A.Anastasi, “Transparenca një rrugë drejt besimit të publikut”, “Roli i Organizatave për forcimin e rendit kushtetues në Shqipëri”, botim i QAGJZH, Tiranë 2008, fq.64.

³⁹ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2010, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, neni. 13.

Neni 34 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, “Kërkesat individuale” parashikon se Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Organizata mund të luajë një rol aktiv nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të aplikantit/es.

Por, një Organizatë mund të ndërhyjë edhe si palë e tretë në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut përmes komenteve me shkrim (amicus curiae) ose duke marrë pjesë në raste të caktuara në procese.

Një nga pyetjet që ngrihen natyrshëm është a përbën një strategji të organizatës paraqitja e komenteve me shkrim, ndërhyrja si palë e tretë krahasuar me mbrojtjen e aplikantit/es në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut nëpërmjet kërkesës individuale/komunikimit?

Termi “amicus curiae⁴⁰”/mik i gjykatës nënkupton një “jo pale” në proces, e cila në mënyrë vullnetare ose e ftuar nga gjykata paraqet pikëpamjet e saj në lidhje me çështje që prezantohen në çështjen gjyqësore sepse ajo ka një interes aktual ose perspektivë mbi çështjen që nuk mund të përfaqësohet në mënyrë adekuate nga palët. Zakonisht, ky mik i gjykatës paraqet vetëm ndërhyrjen me shkrim, por në disa raste lejohet gjithashtu të marrë pjesë në argumente me gojë.

Përveç origjinës së tij të lashtë, gjurmët e përdorimit të “amicus curiae” mund ti gjejmë në historinë e hershme të common law⁴¹.

Gjykata Europiane Njeriut organizatat marrin pjesë në çështje të vitit 1981, Young,

Një nga avantazhet e kësaj strategjie të ndërhyrjes si palë e tretë është fakti që nuk nevojitet pëlqimi i palës.

për të Drejtat e mundësinë që jofitimprurëse të procedura në një

James and Webster v.

UK, në të cilën u autorizua një përfaqësues i Kongresit të Sindikatave të bënte një prezantim me gojë bazuar në nenin 38 (1) të rregullave të Gjykatës. Në këtë kohë përmbajtja e dispozitës ishte si vijon: “Dhoma mundet me kërkesë të një Pale, ose të Delegatëve të Komisionit, ose proprio motu, të vendosë të dëgjojë „... në çdo kapacitet tjetër çdo person, provat apo deklaramet e të cilit duket se e asistojnë atë në kryerjen e detyrave të saj.

U amendua neni 37 (2) i rregullave të gjykatës duke lejuar në mënyrë eksplicite ndërhyrjet e organizatave. Ky rregull më vonë u inkorporua në nenin 36 (2) të Konventës pas hyrjes në fuqi të Protokollit 11.

Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe Rregullat më të fundit të gjykatës të Korrikut të 2006-ës (amenduar në qershor të 2010-ës) parashikojnë

⁴⁰ Referuar Fjalorit të së drejtës.

⁴¹ Jorgo E. Vinales, “Të drejtat e njeriut dhe arbitrimi i investimeve. Roli i amici curiae”, 2006, fq.236.

mundësinë që një organizatë jofitimprurëse të ndërhyjë si palë e tretë në Gjykatën Europiane të të drejtave të njeriut, duke i hapur rrugën ndërhyrjeve të organizatave si palë të treta pranë kësaj gjykate.

Neni 36, p.2 i Konventes për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore parashikon në lidhje me ndërhyrjen e palës së tretë se: “Kryetari i Gjykatës, në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë, mund të ftojë çdo Palë Kontraktuese që nuk është palë në gjykim ose një person të interesuar që nuk është kërkues të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seance”. Pra, kjo mundësi i shërben mirë administrimit të rregullt të drejtësisë.

Rregulli 44, p. 2(a) parashikon se “Menjëherë pas njoftimit të palës së paditur kontraktuese për aplikimin,...Presidenti i Dhomës mund që në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë, siç parashikohet në nenin 36, 2 të Konventes, fton ose i jep leje një pale kontraktuese e cila nuk është palë në proces, ose çdo personi të interesuar që nuk është kërkuesi të paraqesë komentet me shkrim, ose në raste të veçanta, të marrë pjesë në proces”.

Pavarësisht nga fakti se në këto dispozita theksi vihet mbi asistencën që ofron për gjykatën ndërhyrja si palë e tretë e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të grave nga pabarazitë dhe diskriminimi, këto të fundit e përdorën si mundësi për të mbështetur interesin publik dhe advokimin. Kjo do të thotë se organizatat e panë këtë ndërhyrje jo vetëm si një mundësi për hedhur dritë mbi aspekte të vështira ligjore, duke kontribuar në zhvillimin e të drejtës por edhe si një mundësi për të mbështetur grupin e individëve që qëndrojnë pas palës, për të sjellë ndryshime sociale dhe ligjore, për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me një çështje të caktuar. Natyrshëm, pozicioni i palës në çështje forcohet nga argumentat e sjella nga Organizata nëpërmjet komenteve me shkrim të saj.

Sipas Rregullit 44, p.2, b, kërkesa për leje për këtë qëllim duhet të jetë e mirë arësytuar dhe të paraqitet me shkrim në një nga gjuhët zyrtare jo më vonë se 12 javë pasi njoftimi i aplikimit të jetë dhënë palës së paditur kontraktuese. Një tjetër kufi kohor mund të fiksohet nga Presidenti i Dhomes për shkaqe të veçanta.

Mospërmbyshja e kushteve të tilla bën që Presidenti i Dhomës mund të vendosë të mos përfshijë komentet në dosjen e çështjes ose të kufizojë pjesëmarrjen në seance, në atë masë që ai e konsideron të nevojshme.

Organizata jofitimprurëse mund të paraqesë një letër zyrtare, nëpërmjet së cilës të kërkojë leje për të ndërhyrë. Në këtë kërkesë përcaktohen detaje mbi organizatën ndërhyrëse, profilin e saj dhe ravijëzohen çështjet e propozuara për tu adresuar në paraqitjen me shkrim. Komentet me shkrim ju dërgohen palëve të çështjes, të cilët kanë të drejtën të paraqesin observimet e tyre me shkrim. Këto observime në përgjigjen e palëve i dërgohen organizatës ndërhyrëse për komente të mëtejshme.

Ndërhyrja e palës së tretë mund të asistojë gjykatën në qartësimin e kontekstit në të cilin një politikë ose praktikë e veçantë është miratuar ose zbatohet nga një shtet palë i Konventës.

Kërkesat për leje për të ndërhyrë si palë e tretë zakonisht lidhen me çështje të meritave por është e mundur të paraqiten edhe në lidhje me vendimin për pranueshmërinë e çështjes. Komentet me shkrim të paraqitura sipas këtij rregulli përgatiten në një nga gjuhët zyrtare, anglisht ose frëngjisht.

Një nga çështjet më të rëndësishme në aplikimin për leje, për të paraqitur komente me shkrim për një çështje të caktuar që lidhet me të drejtat e njeriut, e në mënyrë të veçantë me dhunën me bazë gjinore është cili është interesi i Organizatës Jofitimprurëse që po ndërhyr si palë e tretë. Kjo kërkon një spjegim të qëllimit të organizatës, misionit të saj, aktiviteteve që ajo zbaton për arritjen e qëllimit, eksperiencës së organizatës dhe garantimit të statusit të ndërhyrësit si palë e tretë në çështje të tjera. Në vijim është e rëndësishme të shpjegohet se si çështjet që ngrihen në çështjen gjyqësore konkrete lidhen me fokusin e organizatës dhe se si vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të njeriut do të sillte një impakt të rëndësishëm në të drejtat e target grupit të cilit organizata i shërben.

Për të analizuar ndërhyrjen si palë e tretë të Organizatës para Gjykatës Evropiane për të

Kushtet që duhet të përmbushë kërkesa e organizatës për të marrë leje për ndërhyrje si palë e tretë në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut janë:

- Ti adresohet sekretarit të seksionit përkatës;
- Ti referohet emrit të çështjes, numrit të aplikimit dhe rregullit 44;
- Të shpjegojë misionin e organizatës, ekspertizën dhe se si çështjet që ngrihen në këtë çështje paraqitur Gjykatës Evropiane lidhen ngushtë me punën e organizatës;
- Të përcaktojë çështjet e propozuara për tu adresuar;
- Të përfshihet një konkluzion shkurt mbi kërkesën për leje;

Drejtat e Njeriut po i referohem eksperiencës së pasur të dy organizatave Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut, Interights në Londër dhe Qendrës për të Drejtat në fushën e shëndetit riprodhues, në New York.

Një nga organizatat që ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm duke paraqitur komente me shkrim përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në mënyrë të vazhdueshme dhe në

lidhje me çështje të mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi është Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut, Interights në Londër. Vetë ose në bashkëpunim me organizata të tjera, kjo organizatë ka paraqitur komente me

shkrim para Gjykatës Evropiane për disa çështje si M.C. v Bulgaria, Nachova dhe të tjerë v. Bulgaria, D.H. dhe të tjerë v. Republikës Ceke dhe Nahide Opuz v. Turkey. Çështja M.C. v Bulgaria paraqet një interes të veçantë për organizatat, për të analizuar ndërhyrjen e Interights si palë e tretë në çështje që lidhen me adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Kështu, në komentet me shkrim të Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut, Interights për aplikimin no.33401/02, Nahide Opuz v. Turkey shpjegohet interesi i Organizatës si ndërhyrëse.

Interesi i Organizatës ndërhyrëse në këtë rast është se çështja ngre disa çështje kritike, që lidhen me natyrën e detyrimeve pozitive të shteteve, në lidhje me të drejtat e njeriut për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe mbrojtjen nga diskriminimi, përmbushjen e tyre nga Shtetet Palë.

Në aplikimin e Qendrës për të Drejtat në fushën e shëndetit riprodhues, (një tjetër qendër me eksperiencë në ndërhyrje para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) paraqitur sekretarit të Gjykatës, për leje për të paraqitur komente me shkrim në çështjen Tysiac v. Polonisë, Aplikimi nr.5410/03 shpjegohet misioni i organizatës, objektivat dhe qëllimet e saj dhe më pas shpjegohet interesi i saj në këtë ndërhyrje. Në kërkesë shpjegohet se vendimi i Gjykatës në lidhje me këtë çështje mund të ketë ndikime të rëndësishme për të drejtat e grave në fushën e shëndetit riprodhues, jetës private, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Në çështjen Vo v.France, Aplikimi nr.53924/00, Qendra për të Drejtat në fushën e shëndetit riprodhues spjegon interesin e saj në ndërhyrjen si palë e tretë: “Çështja Vo. v France ka ndikime të rëndësishme për të drejtat e shëndetit riprodhues të grave. Gjykatës i është kërkuar ti japë për herë të parë fetusit të palindur statusin e personit me të drejta sipas Konventës Evropiane....Ajo do të vendoste bazat teorike për një kërkesë sipas së cilës të drejtat e një fetusit të palindur kanë prioritet mbi ato të një gruaje shtatzënë. Një kërkesë e tillë nëse do të konsiderohej do të shkonte në drejtim të kundërt me jurisprudencën e konsoliduar të sistemit të të drejtave të njeriut evropian dhe do ti kthente ligjet e abortit në shumicën e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës në të pavlefshme sipas nenit 2 të Konventës.Të drejtat e grave të privatësisë, jetës dhe sigurisë e barazisë do të rrezikoheshin rëndë.”

Kjo ndërhyrje është shumë e pasur me referime në jurisprudencën e Sistemit Evropian të të drejtave të njeriut (referim në çështjen Paton v. U.K.; R.H. v. Norway; Boso v. Italy), legjislacionin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, standardet ndërkombëtare dhe rajonale dhe jurisprudencën kombëtare nga shtetet e përzgjedhura jo evropiane.

Paraqet një interes të veçantë në këtë ndërhyrje argumentimi se garantimi fetusit të palindur i statusit të një personi sipas ligjit ndërhyrëse në të drejtat njerëzore bazë të grave, si e drejta për jetën private, jetën dhe sigurinë e personit, dhe të drejtën për barazi. Në lidhje me të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim, ndërhyrja referohet në analizat e Komitetit CEDAW të efekteve të kufizimeve të së drejtës për abort në të drejtën e grave për barazi. Sipas këtyre analizave “ligjet që kriminalizojnë procedurat

mjeksore që ju nevojiten vetëm grave dhe që i ndëshkojnë gratë që ju nënshtrohen këtyre procedurave” përbëjnë një pengesë për kujdesin e duhur shëndetsor për gratë, kompromentojnë të drejtën për mosdiskriminim në fushën e shëndetit.⁴²

Kjo qendër ka eksperiencë të gjatë dhe ka paraqitur ndërhyrje si palë e tretë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjet *Vo v. France, D v. Ireland dhe A, B, dhe C v. Irlandës*. Në çështjen *Tysiac v. Polonisë*, një numër organizatash në nivel kombëtar paraqitën ndërhyrje si palë të treta.

Çfarë duhet të konsiderojë një Organizatë Jofitimprurëse në rastet kur fillon nga puna për përgatitjen e ndërhyrjes.

Së pari nuk komenton mbi faktet e çështjes por adreson vetëm parimet e përgjithshme që përfshihen në zgjidhjen e çështjes. Nëse në një ndërhyrje organizata adreson fakte të veçanta të çështjes, gjykata mund të mos e konsiderojë këtë informacion. Në këtë kuadër, përgatitja e komenteve me shkrim kërkon një kujdes të veçantë.

Së dyti organizata Jofitimprurëse siguron informacion që gjykata nuk e ka mbi çështjet që ngre kjo çështje drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Së treti në ndërhyrjen e saj ofrohet informacion mbi kontekstin kombëtar, nga i cili vjen çështja paraqitur Gjykatës për të Drejtat e Njeriut.

Së katërti ndërhyrja jep informacion mbi ligjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe jurisprudencën e gjykatave të brendshme në lidhje me çështjet që ngre çështja në fjalë. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale mbi të drejtat e njeriut zënë vend në komentet me shkrim të organizatës.

Së fundi ndërhyrja jep informacion mjaft të rëndësishëm mbi praktikën e zbatimit të ligjit në rajon ose botë, shembuj krahasues.

Kushtet e veçanta të përcaktuara për ndërhyrjen nëpërmjet *amicus curiae*, në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut reflektojnë gjithashtu perceptimin e gjykatës mbi rolin që *amici curiae* duhet të luajë në këto procese.

Komentet me shkrim të Organizatës Interights për aplikimin no.33401/02, *Nahide Opuz v. Turkey* u përqëndruan në: Kontekstin e dhunës në familje, impaktin dhe përhapjen e dhunës në marrëdhëniet familjare, karakterizimin historik si sferë private dhe pasojat, sfidat e veçanta në përgjigjet ligjore ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

⁴² Komiteti CEDAW, Gratë dhe shëndeti, Rek. i Përgjithshëm nr.24, sesioni i 20-të, par.14.

Komentet ishin të fokusuar në tre pjesë: 1. Burimi dhe përmbajtja e detyrimeve të shtetit për të punuar me “zellin e duhur” për mbrojtjen dhe përgjigjet ndaj dhunës në familje. Duke ju referuar standardeve dhe praktikës ndërkombëtare, pjesa e dytë e komenteve sygjeron masa operacionale dhe legjislative minimale për ti bërë këto detyrime të efektshme. Pjesa e fundit fokusohet në zhvillimet e të drejtës për njohjen e dhunës në marrëdhëniet familjare si diskriminim.

Në aplikimin e Qendrës për të Drejtat në fushën e shëndetit riprodhues⁴³ paraqitur sekretarit të Gjykatës, për leje për të paraqitur komente me shkrim në çështjen Tysiac V Polonisë, Aplikimi nr.5410/03, çështja e propozuar për tu adresuar ishte se mungesa e ligjeve, politikave, rregulloreve që sigurojnë aksesin e grave në abortin ligjor dhe të sigurt, veçanërisht në kontekstin e abortit për shkaqe shëndetsore është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara në Konventë dhe të zbatuara nga organet e Konventës.

Në komentet e me shkrim nga organizatë, një rëndësishëm legjislativ

Cili është impakti i ndërhyrjes si palë e tretë Në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

paraqitura kjo vend të zunë dhe

jurisprudenca e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës dhe mekanizmeve ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu edhe strukturat monitoruese të konventave të Kombeve të Bashkuara, mbi detyrimin e shteteve për të siguruar një kuadër ligjor i cili i garanton një gruaje shtatzënë të drejtën për të ndërprerë shtatzaninë për shkaqe mjeksore. Në komentet me shkrim të paraqitura gjykatës u përfshi edhe informacion mbi të drejtën europiane, dhe rregulloret mbi procedurat gjyqësore në lidhje me abortin në mënyrë të veçantë abortin teraupetik dhe mekanizmat nëpërmjet të cilave vendime të tilla mund të apeloohen ose rishikohen.

Së pari Gjykata i referohet amicus briefs në vendimet e saj. Ajo përgjithëson informacionin e siguruar nga ndërhyrja e palës së tretë. Gjithashtu, Gjykata i referohet informacionit për të mbështetur vendimin. Kështu, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i referohet komenteve të paraqitura nga organizata Interights në lidhje me pretendimin se janë cënuar të drejtat e parashikuara në nenin 2 të Konventës, (e drejta e jetës), në nenin 3 të Konventës (e drejta për mbrojtjen nga tortura dhe trajtimet degraduese, çnjerëzore), nenin 14, të lexuar bashkë me nenin 2 dhe 3 të Konventës dhe në përfundim vendimi i Gjykatës Evropiane ka konkluduar se është cënuar neni 2 i Konventës, Neni 3 i Konventës dhe neni 14 i Konventës i lexuar bashkë me nenin 2 dhe 3 të Konventës. Referimi i Gjykatës Evropiane në argumentat e komenteve me shkrim të organizatës rezulton edhe në vendimin e Gjykatës për çështjen M.C v. Bulgaria⁴⁴. Në çështjen Tysiac v. Polonisë, Gjykata Evropiane jo vetëm përmbledhi ndërhyrjen e Qendrës për të Drejtat në fushën e shëndetit riprodhues, por u mbështet në të kur vendosi

⁴³ Znj.Christina Zampas është këshilltare ligjore për Evropën, pranë kësaj qendre. Eksperienca e saj dhe Qendrës për të Drejtat në fushën e shëndetit riprodhues janë konsultuar në përgatitjen e këtij artikulli.

⁴⁴ Vendimi i Gjykatës Evropiane për çështjen M.C v. Bulgaria citon se: “Siç edhe Interights (organizatë joqeveritare në Londër) kishte paraqitur, viktimat e abuzimit seksual, në mënyrë të veçantë, vajzat nën moshën e pjekurisë, shpesh nuk rezistojnë fizikisht për një varg arësyesh psikologjike ose për shkak të frikës për dhunë të mëtejshme nga dhunuesi”.

çfarë masash të përgjithshme duhet të ndërmarrë Polonia me qëllim që gra të tjera të mos përballen me të njëjtat probleme si aplikantja Tysiac.

Nuk rezulton të kemi ndërhyrje pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Organizatat që punojnë në vendin tonë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi.

Disa nga çështjet që ngrihen për diskutim janë:

- A kanë Organizatat Jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore dhe diskriminimi kapacitetet e duhura për njohjen e këtij mjete dhe përdorimin e tij? Ka nevojë për forcimin e kapaciteteve të organizatave me qëllim njohjen dhe përdorimin prej tyre të mjeteve të sipërpërmendura si vënia në lëvizje e Gjykatës Evropiane ose ndërhyrja si palë e tretë pranë kësaj Gjykate, me qëllim mbrojtjen më efektive të interesave të target grupit të cilit ato i shërbejnë.
- Në kushtet kur, nuk ka kërkesa të paraqitura para Gjykatës Evropiane nga viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe individë të diskriminuar kjo sjell që të mos kemi raste kur aplikanti/ja ti kërkojë Organizatës të ndërhyjë si palë e tretë, pra të paraqesë komente me shkrim për të mbështetur pozitën e tij/saj ose që vetë gjykata të ftojë Organizatën të paraqesë komente me shkrim në kuadrin e një kërkesë të caktuar paraqitur para Gjykatës.
- A ka komuniteti njohuri mbi këtë mundësi ligjore, e cila do të mundësonte që kërkuesi/ja ti drejtohej Gjykatës Evropiane në rastet e shkeljes së të Drejtave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore ose ti drejtohej një organizate duke i kërkuar të ndërhyjë si palë e tretë? Nuk ka edukim ligjor të mjaftueshëm të komunitetit dhe kjo shtron nevojën e përpjekjeve të vazhdueshme të të gjithë aktorëve me qëllim rritjen e nivelit të njohurive të komunitetit për të drejtat e tyre ligjore dhe mënyrën se si ti përdorin ato.

Garancitë ndërkombëtare mund të përfshijnë jo vetëm Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por edhe Komitetet e ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është pjesë⁴⁵. Çdo Organizatë jofitimprurëse që punon në fushën e të drejtave të njeriut që përfshihen në çdo traktat mund të ndërveprojë me mekanizmat e traktateve⁴⁶. OJF-të mund të paraqesin ankesa para Komitetit të të Drejtave të Njeriut, Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, Komitetit kundër Torturës dhe Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Racial.

⁴⁵ A.Anastasi, "Transparenca një rrugë drejt besimit të publikut", "Roli i Organizatave për forcimin e rendit kushtetues në Shqipëri", botim i QAGJZH, Tiranë 2008, fq.64.

⁴⁶ Një libër për OJF-të përgatitur nga Zyra e Komisionerit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, fq.58.

Komuniteti, në mënyrë të veçantë grupet në nevojë do të forcoheshin nëpërmjet rolit aktiv të organizatave, duke përdorur mjetet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në favor të tyre.

BIBLIOGRAFIA

1. Ligji Nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

2. Ligje:

- Ligji nr.8485/12.5.1999 “Për procedurat administrative”;
- Ligji Nr. 6340, datë 26.06.1981- Kodi Civil
- Ligji nr.8600/10.4.2000, Për një shtesë në Ligjin nr. 8454/4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit";
- Ligji nr.9398/12.5.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8454/4.2.1999 "Për AP", ndryshuar me Ligjin nr. 8600/10.4.2000;
- Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”;
- Ligji nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2010, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;

3. Studime e Monografi

- Luan Omari, Aurela Anastasi - “*E Drejta Kushtetuese*” - Shtëpia Botuese ABC, Tiranë 2010
- Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda (Methasani) Cani – “*Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, Shtëpia Botuese Adelprint, Tiranë 2011, financuar nga Fondacioni Konrad Adenauer
- *Debati Kushtetues*, Botim i OSBE, Vëllimi 2, Tiranë 2006.
- Komentar “Ligjet për organizatat jofitimprurëse” Instituti i Studimeve Publike dhe ligjore, Tiranë, 2003;
- Prof.dr. A.Anastasi, “Transparenca një rrugë drejt besimit të publikut”, “Roli i Organizatave për forcimin e rendit kushtetues në Shqipëri”, botim i QAGJZH, Tiranë 2008;
- Fjala e Presidentit të Republikës ShtZ. Bamir Topi me rastin e 10 vjetorit të institucionit të Avokatit të Popullit.
Burimi <http://www.avokatipopullit.gov.al/Aktivite/Akt2%2010122009.htm> (aksesuar në Nëntor 2010);
- Indeksi i Reformës Gjyqësore. Shqipëri Vol IV;

- Projekt ligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe gjykatat administrative”;
- Prof. asoc. Dr. Ardian Nuni & Asim Vokshi (Ma) “Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil”, botuar në revistën juridike shkencore “Jeta Juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, Viti i shtatë i botimit, nr.1, mars 2010;
- Jorgo E. Vinuales, “Të drejtat e njeriut dhe arbitrimi i investimeve. Roli i amici curiae”, 2006;
- Komiteti CEDAW, Gratë dhe shëndeti, Rek. i Përgjithshëm nr.24;

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut

- Vendimi i Gjykatës Evropiane për çështjen M.C v. Bulgaria
- Driza v Shqipërisë (33771/02); Qufaj Co Shpk v. Shqipërisë (54268/00 datë 18.11.2004); Marini v. Shqipërisë (3738/02, datë 8.12.2007).

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.40, datë 6.5.1999;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.12, datë 21.03.2000;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 47, datë 28.07.2000;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.43, datë 18.05.2001;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.185, date 26.11.2001;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.206, datë 24.12.2001;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 208, datë 24.12.2001;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.135, datë 17.06.2002;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.4, datë 17.02.2003;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.15, datë 17.04.2003;
Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 25, datë 30.07.2003;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.34, datë 08.12.2003;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.16, datë 11.11.2004;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 26, datë 02.11.2005;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.30, datë 01.12.2005;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.34, datë 20.12.2005;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.20, datë 11.07.2006;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.9, datë 26.02.2007;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.11, datë 04.04.2007;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 35, datë 10.10.2007;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.41, datë 16.11.2007;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.9, datë 19.03.2008;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.10, datë 19.03.2008;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.16, datë 25.07.2008;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 17, datë 25.07.2008;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 25, datë 29.07.2008;

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 12, datë 28.04.2009;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.20, datë 09.07.2009;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.24, datë 24.07.2009;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.26, datë 24.07.2009;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 3, datë 05.02.2010;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 4, datë 12.02.2010;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 11, datë 06.04.2010;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 28, datë 27.05.2010;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 31, datë 18.06.2010;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 33, datë 24.06.2010;
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.49 datë 31.07.2000;